



# PROGRAMI PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL **2017**

**MASA 101:** INVESTIMET NË ASETET FIZIKE  
NË EKONOMITË BUJQËSORE

**MASA 103:** INVESTIMET NË ASETET FIZIKE NË PËRPUNIMIN  
DHE TREGTIMIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE

**MASA 302:** DIVERSIFIKIMI I FERMAVE  
DHE ZHVILLIMI I BIZNESEVE

**MASA PËR UJITJEN E TOKAVE BUJQËSORE**

# **PROGRAMI PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL 2017**







### **Të nderuar fermerë, përfaqësues të agro - bizneseve dhe banorë të zonave rurale,**

Sikur edhe programet e kaluara, edhe Programi për Zhvillim Rural 2017 (PZHR 2017) është punuar me përkushtim të madh dhe në bashkëpunim me të gjithë akterët e përfshirë në avancimin e sektorit të bujqësisë. Çdo vit, me mbështetjen tonë, po shënohet progres i ndjeshëm në të gjithë nën sektorët e bujqësisë, por jemi të vetëdijshëm që ende kemi sfida para vetës, të cilat edhe ky program synon t'i adresoj. Struktura e vogël e pronës bujqësore sfidon menaxhimin efikas të fermës, prandaj PZHR 2017 fokusohet në investime që mbështesin prodhimtarinë bujqësore të orientuar kah tregu dhe fermat që janë ekonomikisht të qëndrueshme dhe me potencial për të furnizuar tregun vendor, për të zëvendësuar importet e larta dhe potencialisht për eksport në rajon dhe në Bashkimin Evropian. Pra, synimi ynë mbetet që të shtojmë sipërfaqet e tokës së punuar, duke rritur prodhimin dhe produktivitetin. Një fakt tjetër është se shumica e fermave përballen me makineri dhe pajisje teknologjike të vjetruar, duke iu pamundësuar fermerëve të aplikojnë sistemet moderne të menaxhimit të fermës për kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore apo rritjen dhe mbarështimin e kafshëve. Prandaj, në PZHR 2017 prioritet i lartë i është dhënë investimeve në modernizimin e makinerisë dhe pajisjeve teknike, por po ashtu edhe në modernizimit të ndërtesave / objekteve, si dhe depove për ruajtje dhe paketim, me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe arritjes së standardeve ndërkombëtare. Investimet përmes PZHR 2017 do të ndikojnë në përmirësimin e aftësisë konkurruese dhe potencial-

in prodhues të sektorit, veçanërisht duke tërhequr investime të tjera publike dhe private. Rezultatet e arritura përmes këtyre investimeve në prodhimtarinë primare në sektorin e bujqësisë, pa dyshim do të kenë ndikim pozitiv edhe në industrinë ushqimore. Sektori i agro - përpunimit vazhdon të ballafaqohet me konkurrencë të lartë të prodhimeve nga importi. Në mënyrë që të zëvendësohen importet e produkteve me vlerë të shtuar, sektori i përpunimit të ushqimit duhet të modernizojë në vazhdimësi linjat e përpunimit sipas teknologjive të fundit. Për këtë arsye PZHR 2017 do të mbështesë ndërmarrjet agro - përpunuese në përmirësimin e linjave përpunuese, diversifikimin e prodhimeve dhe arritjen e standardeve të cilësisë, siç janë standardet HACCP, ISO 22000, etj., me qëllim që t'i përmbushim kërkesat e tregut për produkte të llojllojshme dhe me cilësi të lartë. Me qëllim të reduktimit të migrimin dhe të varfërisë në zonat rurale, ky program synon të krijojë mundësi për vende të reja pune, duke e përkrahur diversifikimin e aktiviteteve bujqësore, si p.sh. përpunimin e produkteve ushqimore që janë tradicionale, grumbullimin e bimëve mjekuese dhe aromatikë, si dhe stimulimin e iniciativave afariste për ofrimin e shërbimeve të ndryshme në zonat rurale. Zhvillimi i bujqësisë intensive dhe konkurruese është i pamundur pa zhvillimin e sistemit të ujitjes. Kjo bëhet edhe më e rëndësishme nëse merren parasysh ndryshimet klimatike të viteve të fundit dhe ato që parashihen në të ardhmen. Për të tejkaluar mungesën e ujit në sezonin e verës, si dhe për të përmirësuar prodhimtarinë intensive bujqësore, veçanërisht të pemëve dhe perimeve, në PZHR 2017 janë paraparë investime në projektet e ujitjes të fokusuar më shumë në sistemet moderne të cilat i menaxhojnë humbjet e ujit dhe ujisin sipërfaqe më të mëdha të tokave bujqësore. Në jemi përpjekur edhe këtë vit, sikur çdo herë tjetër, që të zgjerojmë mundësitë e investimeve, t'i orientojmë drejt ato dhe të lehtësojmë sa më shumë kriteret konkurruese. Ne do të vazhdojmë të jemi transparent në çdo fazë të procesit që ndërlihet me zbatimin e këtij programi. Unë besoj që PZHR 2017 do të vazhdojë të ketë ndikim direkt në rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit të bujqësisë, në përmirësimin e jetës së banorëve të zonave rurale, në krijimin e vendeve të reja të punës dhe në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit.

**Qoftë një vit i mbarë për të gjithë!**

***Memli Krasniqi***

Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë  
dhe Zhvillimit Rural

## TABELA E PËRMBAJTJES

### MASA 101: INVESTIMET NË ASETET FIZIKE TË EKONOMIVE BUJQËSORE ..... 7

1. Baza ligjore .....	7
2. Arsyeshmëria .....	7
3. Objektivat e përgjithshme .....	11
4. Lidhja me masat e tjera në pbzhr .....	12
5. Përfituesit përfundimtar .....	12
6. Kriteret e përbashkëta të pranueshmërisë.....	13
7. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë .....	15
8. Investimet e pranueshme.....	16
9. Kriteret e përzgjedhjes për nënsektorë .....	19
10. Shkalla e përkrahjes publike .....	24
11. Buxheti .....	24
12. Indikatorët e programit .....	25
13. Procedura administrative .....	26
14. Afati i zbatimit.....	26
15. Shtrirja gjeografike e masës .....	26

### MASA 103: INVESTIMET NË ASETET FIZIKE NË PËRPUNIMIN DHE TREGTIMIN E PRODHIMEVE BUJQËSORE PËR VITIN 2017 ..... 27

1. Baza ligjore .....	27
2. Arsyeshmëria .....	27
3. Objektivat e përgjithshme .....	31
4. Lidhja me masat e tjera në pbzhr .....	32
5. Përfituesit përfundimtarë .....	32
6. Kriteret e përbashkëta të pranueshmërisë.....	32
7. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë .....	34
8. Investimet e pranueshme.....	35
9. Kriteret e përzgjedhjes .....	37
10. Shkalla e përkrahjes publike .....	39
11. Buxheti .....	40
12. Indikatorët e programit .....	40
13. Procedura administrative .....	41
14. Afati i zbatimit.....	41
15. Shtrirja gjeografike e masës .....	41

<b>MASA 302: DIVERSIFIKIMI I FERMAVE DHE ZHVILLIMI I BIZNESEVE .....</b>	<b>42</b>
1. Baza ligjore .....	42
2. Arsyeshmëria .....	42
3. Objektivat e përgjithshme .....	43
4. Lidhja me masat e tjera në pbzhr .....	44
5. Përfituesit përfundimtar .....	44
6. Kriteret e përbashkëta të pranueshmërisë.....	44
7. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë .....	45
8. Investimet e pranueshme.....	47
9. Kriteret e përzgjedhjes për nënmasa.....	49
10. Shkalla e përkrahjes publike .....	51
11. Buxheti .....	52
12. Indikatorët e programit .....	52
13. Procedura administrative .....	53
14. Afati i zbatimit.....	53
15. Shtrirja gjeografike e masës .....	53
<b>MASA PËR UJITJEN E TOKAVE BUJQËSORE .....</b>	<b>54</b>
1. Baza ligjore .....	54
2. Arsyeshmëria .....	54
3. Objektivat e përgjithshme .....	54
4. Lidhja me masat e tjera në pbzhr .....	55
5. Përfituesit përfundimtare .....	55
6. Kriteret e përbashkëta të pranueshmërisë .....	55
7. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë .....	56
8. Investimet e pranueshme.....	56
9. Kriteret e përzgjedhjes .....	56
10. Shkalla e përkrahjes publike .....	57
11. Buxheti .....	57
12. Indikatorët e programit.....	58
13. Procedura administrative .....	58
14. Afati i zbatimit.....	58
15. Shtrirja gjeografike e masës .....	58
16. Buxheti i përgjithshëm i i programit të zhvillimit rural 2017.....	58



# MASA 101: INVESTIMET NË ASETET FIZIKE TË EKONOMIVE BUJQËSORE

## 1. BAZA LIGJORE

- Ligji Nr. 03/L-098 - Për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, dt. 1 korrik 2009;
- Ligji Nr. 03/L-029 - Për Inspeksionin Bujqësor, dt. 13 dhjetor 2008;
- Ligji Nr. 03/L-042 - Për Produktet për Mbrojtjen e Bimëve, dt. 27 nëntor 2008;
- Ligji Nr. 02/L-26 - Për Tokën Bujqësore, dt. 23 qershor 2006;
- Ligji Nr. 02/L-9 - Për Ujitjen e Tokave Bujqësore, dt. 25 nëntor 2005;
- Ligji Nr. 2004/13 - Për Materialin Fidanor, dt. 28 maj 2004;
- Ligji Nr. 2003/5 - Për Farërat, dt. 15 prill 2003;
- Ligji Nr.2005/47 - Për Verërat, dt. 14 tetor 2005;
- Ligji Nr. 2004/21 - Për Veterinarinë, dt. 30 korrik 2004;
- Ligji Nr. 04/L-191 - Për Blegtorinë, dt. 28 qershor 2013;
- Ligji Nr. 02/L-10 - Për Përkujdesjen ndaj Kafshëve, dt. 9 maj 2005;
- Ligji Nr. 03/L-024 - Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, dt. 19 mars 2009;
- Ligji Nr. 03/L-025 - Për Mbrojtjen e Mjedisit, dt. 19. mars2009;
- Ligji Nr. 04/L-074 - Për Shërbimet Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, dt. 19 mars 2012;
- Ligji Nr. 04/L-090 – Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-098 - Për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, dt. 16 tetor 2012.

## 2. ARSYESHMËRIA

Spektori i bujqësisë në Kosovë luan një rol shumë të rëndësishëm në ofrimin e mundësive në punësim dhe në krijimin e të ardhurave. Analiza SWOT për bujqësinë e Kosovës thekson zëvendësimin e importit dhe qasjen e lirë në tregun e BE-së, si mundësi e rëndësishme për përmirësimin e të ardhurave kombëtare dhe individuale nga bujqësia në Kosovë. Megjithatë, ky potencial do të realizohet vetëm nëse fermat janë të afta të konkurrojnë me çmimet e tregut në rajon dhe në BE.

Analiza e aftësisë konkurruese e bujqësisë së Kosovës tregon që aktualisht vetëm një pjesë shumë e vogël e fermave mund të konkurrojnë në tregun rajonal, të BE-së dhe atë ndërkombëtar. Shkaktarët kryesorë të kësaj aftësie të ulët konkurruese janë përmasat e vogla të shumicës së bizneseve bujqësore, fragmentimi i tokës së tyre, ndërtesat dhe pajisjet e vjetra, mungesa e mjeteve financiare për investime dhe niveli i ulët i njohurive lidhur me teknologjinë bashkëkohore të prodhimit. Veç kësaj, shumica e fermave nuk i përmbushin standardet e BE-së për siguri dhe higjienë të ushqimit, për mirëqenie të kafshëve dhe mbrojtje të mjedisit.

Një pjesë e madhe e fermave janë aq të vogla sa pothuaj i tërë prodhimi i tyre konsumohet drejt-përdrejt nga familja në fermë. Kështu që ka nevojë për përkrahje të investimeve në asetet fizike të fermave që kanë orientim komercial dhe janë në gjendje të sigurojnë të ardhura të qëndrueshme.

Duke marrë parasysh faktin se shumica e fermave janë shumë të vogla, duket e arsyeshme që të nxitet edhe bashkëpunimi horizontal ndërmjet bujqve në formën e bashkëpunimit të prodhuesve, i



cili mund ta ndërtojë bazën për organizatat e mëvonshme prodhuese, ose shoqatat e prodhuesve, por edhe për integrimin vertikal të bujqve, për shembull në hallkat e tregut përmes kontratave të furnizimit.

Me qëllim të përparimit të metodave të punës dhe zbatimit të inputeve cilësore, do të nxiten fermerët e rinj të moshës prej 18 deri 40 vjeç, të cilët përfaqësojnë bazën për një sektor bashkëkohor dhe inovativ bujqësor.

Në bazë të këtij shqyrtimi, por edhe të përparësisë krahasuese të cilën Kosova e ka në disa sektorë, kontributit të sektorëve në ekonominë e fermave dhe nevojës së sektorëve për përafrim me standartet e BE-së, masa do të përqendrohet në përkrahjen e investimeve në këta sektorë: pemë, perime (përfshirë patatet), qumësht, mish, rrush dhe vezë.

## 2.1 SEKTORI I PEMËVE

Si rezultat i kushteve të mira të kultivimit në shumë rajone të Kosovës, prodhimi i pemëve në Kosovë ka një traditë të gjatë. Mollët (1973 ha) dhe kumbullat (699 ha) përbëjnë pjesën më të madhe sa i përket sipërfaqes prodhuese dhe sasisë, kryesisht të kultivuar në kopshtet e shtëpive dhe me kultivim ekstensiv. Vitet e fundit ka filluar prodhimi më intensiv në pemishtet me mollë, dardha, vishnje dhe kumbulla, ndërsa prodhimi i pemëve manore ka shënuar një rritje të kënaqshme. Në 3-4 vitet e fundit, zhvillim të hovshëm ka përjetuar kultivimi i mjedrës. Aktualisht (2015) janë rreth 800 deri në 900 fermerë komercial që kultivojnë mjedrë në një sipërfaqe të përgjithshme prej rreth 400 ha me një rendiment prej 8-15 t/ha, varësisht nga cilësia e fidanëve dhe përkujdesit të fermerit për fermën e tij.

Janë rreth 300 fermerë që kanë të mbjella rreth 150 ha me dredhëza. Rendimentet janë 15-25 t/ha te pemishtet komerciale me fidanë cilësor. Ndërsa te pemishtet tjera rendimenti është nga 8 – 12 t/ha.

Boronica e kultivuar është në fillim të përhapjes. Aktualisht (2015) janë rreth 20 ha me boronicë të kultivuar.

Megjithatë, prodhimi vendor në shumicën e prodhimeve nuk e arrin vetëmjaftueshmërinë, gjë që lë hapësirë për zgjerimin e sipërfaqeve me prodhim intensiv të pemëve. Momentalisht prodhuesit e pemëve ballafaqohen me disa probleme, si pemishtet e vjetra dhe varietetet me cilësi të dobët, mungesa e mundësive për ujitje, mungesa e depove për ruajtjen e pemëve, pajisjet e dobëta për klasifikim dhe paketim për tregtimin e pemëve. Tregu kërkon sasi të vazhdueshme dhe konsistente të pemëve me cilësi të lartë. Kështu që, kjo nën masë kryesisht synon intensifikimin e prodhimit të pemëve në një sipërfaqe më të gjerë dhe arritjen e standardeve të cilësisë së lartë të produkteve. Përfitues që synohen me këtë nën masë janë fermat me qëndrueshmëri ekonomike me prodhim të orientuar për treg.

Nën masa do të përqendrohet në përmirësimin e efikasitetit të prodhimit, duke përkrahur ngritjen/rehabilitimin e sipërfaqeve të reja me pemishte, modernizimin e pajisjeve për kultivim, sistemet për ujitje që kursejnë ujë dhe makinerinë e përdorur në fermë për ta përmirësuar efikasitetin në fermë si dhe përmirësimin e përgjithshëm të standardeve. Do të përkrahët ndërtimi dhe përmirësimi i objekteve për t'i mundësuar aktivitetet e pas vjeljes. Do të përkrahën edhe investimet e mëtejme në shfrytëzimin e energjisë së ripërtitëshme.

## 2.2 SEKTORI I PERIMEVE DHE SERRAVE (PËRFSHIRË PATATET)

Sektori i perimtarisë, pavarësisht shtrirjes së vogël, është më premtuesi në Kosovë, pasi që ka kushte të mira kultivimi dhe mund të sigurojë rritje të mirë të vlerës së shtuar. Sektori i perimtarisë përbëhet vetëm nga një numër i vogël i kultivuesve komercialë dhe një numër i madh i kultivuesve gjysmë-komercial dhe ekzistencial.

Sektori dominohet nga fermat e vogla private me një sipërfaqe mesatare prej 0.80 hektarë, me prodhimtari dhe rendimente të ulëta si dhe zinxhirë joefikas të furnizimit, me shpenzime të larta për grumbullim dhe logjistikë. Tregtimi i perimeve të freskëta shpesh bëhet pa paketim të përshtatshëm dhe pa klasifikim të prodhimeve.

Në kuadër të kësaj nën mase, përkrahja do të sigurohet për ndërtimin e serrave të përhershme për prodhimin e pemëve manore dhe perimeve si dhe ndërtimin e depove për trajtim pas vjeljes dhe ruajtjen e pemëve dhe perimeve. Nevoja për pemë dhe perime të freskëta gjatë tërë vitit është në rritje. Këtë mungesë në treg mund ta plotësojë më së miri prodhimi në ambiente të mbyllura/mbrojtura. Prodhimi në serra është intensiv në sipërfaqe të vogla që kërkon fuqi relativisht të madhe punëtore (më shumë se kultivimi i prodhimeve të njëjta në fushë të hapur). Në këtë mënyrë kjo nënmasë kontribuon në shtimin e vendeve të punës. Tregu kosovar është i furnizuar me pemë dhe perime të freskëta gjatë tërë vitit, kryesisht të importuara nga vende të ndryshme. Rritja e sipërfaqeve me serra i kontribuon edhe zëvendësimit të prodhimeve të importuara me prodhime vendore, rrjedhimisht edhe përmirësimit të bilancit tregtar negativ të vendit.

## 2.3 SEKTORI I MISHIT

Mishi i gjedhit tradicionalisht është konsideruar si nënprodukt i sektorit të qumështit. Të gjithë viçat vijnë nga fermat prodhuese të qumështit, d.m.th. nuk ekziston një zinxhir furnizimi i mishit, i kompletuar dhe specializuar. Stallat për majmëri janë kryesisht objekte të konvertuara nga objektet për prodhimin e qumështit ose objekte të ndërtuara nga vetë fermerët e vegjël.

Për të shtuar profesionalizmin në mbarështimin e gjedheve për mish, është e nevojshme që të përmirësohen njohuritë teknike të prodhuesve, sidomos të fillestarëve, rreth praktikave të mbarështimit të gjedheve për mish dhe prodhimit të ushqimit për kafshë, duke i përshtatur trajnimet dhe shërbimin këshillues. Mbarështuesit e gjedheve për mish gjithashtu kanë më shumë nevojë për investime në stalla dhe objekte ndërtimore. Investimet në makineri të fermës për prodhim të ushqimit për kafshë dhe investimet në menaxhimin e mbetjeve dhe plehut gjithashtu kanë prioritet të lartë. Ka nevojë për ndërtimin e stallave të reja dhe objekteve të fermave për mbarështim të kafshëve për mish në përputhje me standardet ekzistuese për mirëqenie të kafshëve dhe mjedis. Janë të nevojshme pajisje për fermë si: sistemi i furnizimit me ujë, sistemi i të ushqyerit, largimi i plehut të stallës, makineria e fermës, sidomos për prodhimin, ruajtjen, përgatitjen, përdorimin dhe shpërndarjen e ushqimit të kafshëve. Me këtë nën masë do të synohet përkrahja për fermerët komercialë të specializuar në majmëri të gjedheve.

Sipas Regjistrimit të Bujqësisë (2014) në Kosovë janë 6302 ekonomi bujqësore që mbajnë 34.188 derra apo mesatarisht 5 krerë për ekonomi bujqësore. Shumica e këtyre ekonomive kanë nevojë për investime në stalla moderne dhe objekte përcjellëse me qëllim të shtimit të numrit dhe përmirësimin e kushteve për shëndet dhe mirëqenie të kafshëve.

Konsumi i mishit të shpezëve pritet të rritet edhe më tutje. Meqë shumica e mishit të shpezëve importohet, ka një potencial të madh për zëvendësim të importit. Qasja e përmirësuar në shërbime dhe inpute e ka bërë këtë biznes të mundur edhe për ndërmarrësit e mesëm të cilët nuk kanë kapacitet që të ndërtojnë një cikël të mbyllur, nga prodhimi i ushqimit të kafshëve deri te tregtimi/shitja. Ka nevojë për investime në vendosje/strehim më të mirë të shpezëve, përgatitje të ushqimit cilësor, kontroll të cilësisë, monitorim të shëndetit si dhe ruajtje dhe trajtim të plehut të stallës. Kjo nën masë fokusohet në përkrahjen e prodhuesve ekzistencialë dhe atyre të rinj me madhësi mesatare të fermës, me qëllim të rritjes së aftësisë konkurruese në prodhimin vendor, duke e rritur numrin e prodhuesve të mesëm të brojlerëve (zogjve të pulës) si dhe rritjen e kapaciteteve prodhuese të tyre. Përmes shërbimeve këshilluese dhe trajnimeve profesionale duhet të përmirësohet cilësia e prodhimit me kosto sa më të ulët.

## 2.4 SEKTORI I QUMËSHTIT

Qumështi i lopës është prodhimi më i rëndësishëm blegtoral në Kosovë. Vitet e fundit janë bërë përpjekje që prodhimi i qumështit të kalojë nga prodhimi për konsum familjar në prodhim për treg, që të përmirësohen kushtet e mbarështimit, të zbatohen praktikatat e mira bujqësore në fermat prodhuese të qumështit dhe të rritet kapaciteti i bujqve për prodhim të qumështit me cilësi të lartë.

Cilësia jo e kënaqshme e qumështit të freskët ka shtyrë MBPZHR-në në zbatimin e skemës së pagesave direkte për cilësi të qumështit. Ende ka mjaft hapësirë për përmirësim në asetet fizike si në objekte më të mira, pajisje më bashkëkohore të stallave, sisteme më të mira dhe më bashkëkohore të mjeljes. Nën masa synon përkrahjen e prodhuesve komercial të qumështit.

Modernizimi i sistemeve bujqësore, sidomos të prodhimi intensiv blegtoral, mund të shpijë në rritjen e lirimt të gazrave, të cilat ndikojnë në ndryshimet klimatike. Nën masa do të përkrahë investimet në menaxhimin e plehut të stallës dhe objektet për ruajtjen e tij që zvogëlojnë lirimt e këtyre gazrave, ndërsa prioritet do t'i jepet projekteve të modernizimit që përfshijnë investime të tilla.

Prodhimi i qumështit nga ripërtypësit e vegjël (dele, dhi) është kryesisht një cikël i mbyllur, nga prodhimi i qumështit, të përpunimi i djathit dhe shitja (marketingu) në fermë. Vetëm disa ferma janë komerciale, ndërsa shumica e prodhuesve që mbajnë ripërtypës të vegjël janë ferma të vogla me praktika kryesisht tradicionale të mbarështimit të kafshëve. Ka nevojë të madhe për investime në modernizimin e stallave, objekteve përcjellëse infrastrukturore, për përdorimin e sistemeve të mjeljes, etj.

## 2.5 SEKTORI I RRUSHIT

Ngastrat e vreshtave kryesisht janë të vogla, ndërsa prodhimi i rrushit bëhet nga 4780 vreshtarë. Madhësia mesatare është 0.5 ha me rendiment mesatar prej 8-10t/ha. Vreshtat e Kosovës përfshijnë 751 hektarë me rrush tryeze dhe 2440 hektarë me rrush të verës<sup>1</sup>. Shpenzimet e prodhimit janë të larta pjesërisht për shkak të vreshtave të vjetra, ngastrave të vogla dhe mekanizimit të vjetër. Rrushi i tryezës i prodhuar në vend, ballafaqohet me konkurrencë të fortë nga importi i cili është i kategorizuar dhe paketuar mirë. Prioritet do t'i jepet prodhimit të rrushit të tryezës, por pa e lënë anash edhe prodhimin e rrushit të verës. Investimet në ristrukturimin dhe modernizimin e prodhimit dhe tregtimit të rrushit janë të nevojshme për të konkurruar me prodhimet e importuara.

## 2.6 SEKTORI I VEZËVE

Sektori i prodhimit të vezëve është relativisht mirë i konsoliduar. Prodhimi i vezëve në fermat komerciale vlerësohet të jetë rreth 283 milion vezë (2014) ndërsa në kuadër të ekonomive familjare prodhohen edhe rreth 74 milion copë që rezultojnë me një prodhimtari totale 357 milion vezë. Në vitin 2014 janë importuar rreth 6 milion vezë nga Shqipëria. Konsumi mesatar për kokë banori llogaritet të jetë rreth 200 vezë/vit dhe mund të themi se Kosova plotëson rreth 98% të nevojave për konsum të vezëve.<sup>2</sup>

Shumica e prodhuesve aplikojnë sistemin e mbajtjes në kafaze. Objektet e prodhimit në shumicën e rasteve janë relativisht të vjetra dhe është vështirë të ofrohen prodhimet e kërkuara (vezët, ushqimet, zogjtë, etj.) me çmime konkurruese.

Për ta përmirësuar efikasitetin e prodhuesve mesatarë, prioritet do t'i jepet fermave të mesme me nga 5000 deri 25,000 pula vojse, të cilat mund të përballojnë lëvizjet e mëdha të çmimeve përgjatë viteve dhe të konkurrojnë në tregun dinamik.

Do të sigurohet përkrahje për ta përmirësuar efikasitetin e prodhimit duke investuar në pajisje më të mira për stallë dhe higjienë në stallë (ajrosje, sistem të ujit, sistem të grumbullimit të vezëve, etj).

1 DWV, 2014

2 Raporti i Gjelber 2015

Duhet të përmirësohet menaxhimi i plehut të stallës dhe mbetjeve të tjera, pasi që ndikimi negativ i shpeztarisë intensive në mjedis mund të jetë i lartë nëse nuk trajtohet si duhet, gjersa krijon të hyra shtesë kur menaxhohet si duhet. Shërbimet këshilluese në Kosovë duhet të përmirësohen ashtu që t'u ofrojnë trajnim përkatës prodhuesve të mesëm dhe të vegjël në prodhimin e ushqimit të kafshëve, operimin dhe mirëmbajtjen e linjave gjysmë-automatike për grumbullimin dhe kategorizimin e vezëve.

### 3. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

- Rritja e aftësisë konkurruese të bujqësisë kosovare dhe zëvendësimi i importit;
- Krijimi i vendeve të reja të punës dhe shtimi i punësimit në viset rurale;
- Përkrahja e bujqve në sektorët e përzgjedhur, me qëllim të përafrimit me rregullat, standardet, politikat dhe praktikatat e BE-së;
- Përkrahja e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror duke synuar rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, nëpërmjet zhvillimit të fermave;
- Adresimi i sfidave të ndryshimit klimatik përmes shfrytëzimit të energjisë së ripërtërishme.

#### 3.1 OBJEKTIVAT E VEÇANTA

##### 3.1.1 SEKTORI I PEMËVE DHE SEKTORI I PERIMEVE (PËRFSHIRË PATATET)

- Rritja e prodhimit të pemëve dhe perimeve (përfshirë patatet) për qëllime komerciale;
- Përmirësimi i cilësisë me qëllim të përmbushjes së standardeve përkatëse kombëtare dhe të atyre të BE-së;
- Modernizimi i fermave përmes përdorimit të pajisjeve të reja dhe mekanizimit modern;
- Zvogëlimi i humbjeve pas vjeljes nëpërmjet investimeve në fermë, në teknologjinë e ruajtjes, në infrastrukturë dhe pajisje për fazën pas vjeljes, përfshirë kapacitetet për ftohje, klasifikim dhe paketim;
- Prodhimi i energjisë së ripërtërishme;
- Përmirësimi i integritetit të fermerëve me blerësit e prodhimeve bujqësore.

##### 3.1.2 SEKTORI I QUMËSHTIT DHE SEKTORI I MISHIT

- Rritja e prodhimit në fermat e specializuara;
- Përmirësimi i cilësisë me qëllim të përmbushjes së standardeve kombëtare dhe të atyre të BE-së;
- Modernizimi i fermave përmes përdorimit të pajisjeve të reja dhe mekanizimit modern;
- Zvogëlimi i lirimit të oksidit të azotit dhe metanit përmes trajtimit të duhur të plehut organik dhe mos-ndotjes së ujërave mbitokësore dhe nëntokësore;
- Prodhimi i energjisë së ripërtërishme;
- Përmirësimi i integritetit të fermerëve me blerësit e prodhimeve të tyre.

### 3.1.3 SEKTORI I RRUSHIT

- Rritja e prodhimit të rrushit të tryezës dhe rrushit të verës;
- Përmirësimi i cilësisë me qëllim të përmbushjes së standardeve kombëtare dhe të atyre të BE-së;
- Modernizimi i fermave përmes përdorimit të fidanëve cilësorë dhe mekanizimit modern;
- Prodhimi i energjisë së ripërtërishme;
- Përmirësimi i integritetit të fermerëve me blerësit e produkteve të tyre.

### 3.1.4 SEKTORI I VEZËVE

- Përmirësimi dhe zgjerimi i kapaciteteve ekzistuese prodhuese;
- Përmirësimi i cilësisë me qëllim të përmbushjes së standardeve kombëtare dhe të atyre të BE-së;
- Modernizimi i fermave përmes përdorimit të pajisjeve të reja dhe mekanizimit modern;
- Zvogëlimi i lirit të oksidit të azotit dhe metanit përmes trajtimit të duhur të plehut organik;
- Prodhimi i energjisë së ripërtërishme;
- Përmirësimi i integritetit të fermerëve me blerësit e prodhimeve të tyre;

## 4. LIDHJA ME MASAT E TJERA NË PBZHR

**Kjo masë ka ndërlidhje me masat e tjera të PBZHR-së, si:**

- Masa 103 “Investimet në asetet fizike për përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore” dhe
- Masa 302 “Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve”

## 5. PËRFITUESIT PËRFUNDIMTAR

Përfituesit përfundimtar nën këtë masë janë fermerët, sipas definicionit nga Ligji Nr. 04/L-090 –Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-098 - Për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, dhe ndërmarrjet e tjera bujqësore të regjistruara në Regjistrin e Fermave.

Të gjithë përfituesit e projekteve të zhvillimit rural obligohen t'i mirëmbajnë investimet e tyre sipas projektit të miratuar gjatë pesë vjetëve pas realizimit të projektit, aq sa zgjat periudha monitoruese. Nëse nuk i mirëmban investimet, përfituesi obligohet ta kthejë shumën e financuar të përkrahjes publike.

## 6. KRITERET E PËRBASHKËTA TË PRANUESHMËRISË

### 6.1 APLIKUESIT E PRANUESHËM

- Nëse aplikuesi është person fizik, ai duhet të jetë së paku 18 vjeç, por jo më i vjetër se 65 vjet. Në rastin e personave juridikë ky kriter nuk aplikohet;
- Personi fizik duhet ta ketë të përfunduar së paku shkollën e mesme dhe dy vjet përvojë pune në lëmin në të cilën aplikon. Aplikuesit që nuk kanë përvojë pune dy vjeçare, duhet të ndjekin kurse trajnimi me së paku 20 orë mësimi, në fushën për të cilën aplikojnë, e të cilat do t'i përfundojnë para kërkesës për pagesën e fundit;
- Në rastin e personave juridikë, kërkesa e sipërpërmendur vlen për pronarin ose për personin e autorizuar të ndërmarrjes. Personi i autorizuar duhet të ketë kontratë pune jo më të shkurtër se tre vjet;
- Aplikuesit duhet t'i kenë të shlyera detyrimet tatimore dhe atë, personat fizikë, tatimin në pronë, kurse personat juridikë, tatimin në të ardhura të korporatave dhe tatimet e tjera të aplikueshme;

### 6.2 STANDARDET KOMBËTARE

Standardet kombëtare për shëndetin e kafshëve, mirëqenien e kafshëve dhe mbrojtjen e mjedisit janë të paraqitura në Shtojcën nr. 5 të Udhëzuesit për aplikant. Ato duhet të përmbushen më së voni para kërkesës për pagesën e fundit dhe verifikohen me kontrollin e personit zyrtar në vendin e investimit.

### 6.3 QËNDRUESHMËRIA EKONOMIKE

- Për projektet investuese në të cilat investimet e pranueshme janë më të vogla ose baras me 20,000 €, aplikuesit duhet ta dorëzojnë një projekt-propozim teknik sipas modelit që do të publikohet në ueb faqet e AZHB dhe MBPZHR.
- Për projektet investuese në të cilat investimet e pranueshme janë më të mëdha se 20,000 €, aplikuesit duhet ta dorëzojnë një plan të biznesit sipas modelit që do të publikohet në ueb faqet e AZHB dhe MBPZHR.

### 6.4 KRITERET E TJERA TË PRANUESHMËRISË

- Përfituesit e projekteve me vlerë të investimeve të pranueshme në shumën më të madhe se 50,000 €, para nënshkrimit të kontratës me AZHB, duhet t'i regjistrojnë ndërmarrjet e tyre dhe të gjitha investimet/shpenzimet duhet të faturohen në emër të kësaj ndërmarrjeje.
- Projektet e financuara nga Programi i Zhvillimit Rural 2017 nuk bën të jenë të financuara edhe nga Zyra e BE-së në Kosovë apo ndonjë donator tjetër publik vendor ose ndërkombëtar. Në rast se vërtetohet se përfituesi ka përfituar përkrahje për projektin e njëjtë edhe nga ndonjë donator tjetër, atij nuk i jepet përkrahja ose nëse e ka marrë atë, ai do të detyrohet t'i kthejë mjetet e marra, si dhe ndaj tij do të zbatohen ndëshkimet në përputhje me ligjin.
- Përfituesi, i cili ka aplikuar në MBPZHR dhe institucione tjera publike apo në zyrën e BE-së në Kosovë dhe projekti i tij përzgjidhet për financim nga ndonjëri prej institucioneve, duhet menjëherë të informojë MBPZHR / AZHB apo institucionet tjera përkatëse.

- Të gjithë përfituesit, të cilët në planin e tyre të biznesit kanë deklaruar se do të krijojnë vende të reja të punës dhe për këtë kanë fituar pikë gjatë vlerësimit, duhet t'i krijojnë ato dhe të dëshmojnë me pagesën e kontributit pensional dhe tatimit në paga duke filluar së paku nga muaji i fundit para kërkesës për pagesën e fundit. Përfituesit janë të obliguar ti mbajnë këto vende pune të plotësuara me punëtorë me orar të plotë për 5 vjet, aq sa zgjat periudha monitoruese;
- Përfituesit nuk mund t'i jepet një projekt i ri nëse projektet e mëparshme nuk janë përmbyllur në mënyrë të rregullt.

**Në rastin e projekteve që parashohin ndërtim apo zgjerim, aplikuesit me rastin e aplikimit duhet të dorëzojnë:**

- Kopjen e skicave të objektit dhe një parallogaritje të shpenzimeve të materialit dhe të punëve të parapara;
- Kopjen e planit të parcelës ku do të bëhet investimi;
- Fletën poseduese të parcelës ose në rast se toka është marrë me qira, kontratën e noterizuar të qirasë për së paku 10 vjet për parcelën ku do të bëhet ndërtimi dhe kopjen e planit;
- Pëlqimin e Komunës që dëshmon se në rast të dhënies së grantit, aplikuesi mund të marrë leje ndërtimi;

**Përfituesi, para se të bëjë kërkesën për pagesë në AZHB, duhet të dorëzojë:**

- Lejen për ndërtim nga organi kompetent i Komunës.
- Vlerësimin e ndikimit në mjedis, nëse është paraparë me ligj.

Në rast të ndërtimit, zgjerimit apo renovimit të objekteve, të ngritjes së pemishtes, vreshtit dhe / apo vendosjes së sistemit të ujitjes në toka të marra me qira, kontrata për qiramarrje duhet të jetë për së paku 10 vjet. Kontratës duhet t'i bashkëngjitet pëlqimi i pronarit (qiradhënësit), i vërtetuar te noteri, për investimin që do të bëhet në tokën e tij. Pëlqimi i pronarit mund të përfshihet edhe në kontratën për qiramarrje.

Kontrata për qiramarrje nuk kërkohet vetëm në rastet kur pronari i tokës dhe aplikuesi janë në marrëdhënie bashkëshortore apo në vijë të drejtë të gjakut pa kufij (p.sh.: stërgjyshërit, gjyshërit, prindërit, fëmijët, nipërit, etj.) dhe kjo dëshmohet përmes certifikatës së martesës apo certifikatës së lindjes dhe / apo certifikatës së vdekjes. Po ashtu, aplikuesi duhet të plotësojë Deklaratën nën betim, me të cilën dëshmon se toka me të cilën aplikon është trashëguar nga ai.

## **6. 5 LISTA KONTROLLUESE PËR PËRZGJEDHJE MJEDISORE**

Me rastin e përzgjedhjes së përfituesve, para nënshkrimit të kontratave për financim të projekteve për zhvillim rural, projektet e përzgjedhura do t'i nënshtrohen procedurës së vlerësimit mjedisor, sipas Listës Kontrolluese për Përzgjedhje Mjedisore (shih shtojcën në Udhëzuesin për aplikues – Masa 101-2017). Lista kontrolluese do të plotësohet nga AZHB duke dhënë informata shtesë për rubrikën «Karakteristikat specifike» për t'i sqaruar përgjigjet e dhëna. Nëse një apo më shumë përgjigje në listën kontrolluese është pozitive (PO), atëherë projekti do të ketë ndikim në mjedis, dhe si i tillë kërkon përgatitjen e Planit për Menaxhim Mjedor (PMM).

Masat zbutëse të parashikuara në listën kontrolluese do të jenë pika udhëzuese për përgatitjen e PMM-së. Procesi i aprovimit të projektit kërkon që të gjitha masat zbutëse të propozuara të pranohen dhe të miratohen për zbatim nga ana e aplikuesit. Përgatitja e PMM-së do të jetë obligim i vetë aplikuesit, ndërsa shpenzimet për përgatitjen e tij do të konsiderohen si shpenzime administrative.

## 7. KRITERET E VEÇANTA TË PRANUESHMËRISË

### 7. 1 SEKTORI I PEMËVE (MOLLA, DARDHA, KUMBULLA, VISHNJA, QERSHIA, KAJZIA, PJESHKA, FTONI, DREDHËZA, MJEDRA, MANAFERRA, BORONICA DHE ARONIA)

- Në momentin e aplikimit për investime në sektorin e pemëve, aplikuesit duhet të dëshmojnë se kanë sipërfaqe të tokës bujqësore në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku 10 vjet dhe të regjistruar në Regjistrin e Fermave dhe atë së paku 1 hektar për pemë drufrutore (molla, dardha, kumbulla, vishnja, qershia, kajzia, pjeshka, dhe ftoni) dhe/ose 0.50 hektar për pemë manore (dredhëza, mjedra, boronica, manaferra dhe aronia). Sipërfaqja minimale e ngastrës për pemë manore duhet të jetë 0.25 hektar dhe për pemë drufrutore 0.50 hektar;
- Përfituesit për ngritje të pemishteve të reja, para kërkesës për pagesë, nëse blejnë fidanë të prodhuar në Kosovë, duhet të dorëzojnë kopjen e certifikatës fito-sanitare mbi gjendjen shëndetësore të materialit fidanor që përmbush kriterin CAC (Conformitas Agraria Communitatis) dhe kopjen e licencës së prodhuesit, kurse ata që blejnë fidanë të importuar nga vendet e BE-së, duhet të dorëzojnë kopjen e certifikatës fito-sanitare mbi gjendjen shëndetësore të materialit fidanor që përmbush së paku kriterin CAC të lëshuar nga prodhuesi, certifikatën për prejardhjen e origjinës dhe lejen e importit të ndërmarrjes importuese.
- Fidanët e mbjellë të pemëve drufrutore duhet të kenë të ngjitur në trup etiketën e institucionit certifikues.
- Projektet e nën masës së pemëve manore, duhet që të përfshijnë ndërtimin e depon ftohëse dhe atë: projektet me sipërfaqe  $\geq 0.50$  ha –  $< 1$  ha duhet të ndërtojnë depo me kapacitet së paku 10 t, ndërsa projektet me sipërfaqe  $\geq 1$  ha -  $\leq 2$  ha duhet të ndërtojnë depo me kapacitet së paku 20 t.

### 7. 2 SEKTORI I PERIMEVE DHE SERRAVE (PËRFSHIRË PATATET)

- Në momentin e aplikimit për investime në depo për pemë dhe perime (përfshirë patatën), aplikuesit duhet të dëshmojnë se kanë së paku 2 hektarë sipërfaqe të tokës bujqësore në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku 10 vjet dhe të regjistruar në Regjistrin e Fermës.
- Në momentin e aplikimit për investime në serra të reja të përhershme, aplikuesi duhet të dëshmojë se ka së paku 0.10 hektar tokë të punueshme të regjistruar në Regjistrin e Fermave.

### 7. 3 SEKTORI I MISHIT

- Për investime në sektorin e mishit (majmëria e viçave, derrave dhe zogjve të pulës), aplikuesit nuk janë të obliguar të kenë viça/derra/ zogj në momentin e aplikimit, por para kërkesës për pagesën e fundit duhet të kenë së paku 20 krerë viça, ose 40 derra për trashje me matrikuj të Republikës së Kosovës ose të vendeve të BE-së ose 5,000 zogj pule, dhe këto duhet të dëshmojnë me dokumente përkatëse dhe me praninë e tyre në stallë. Aplikantët që aplikojnë për ndërtimin e stallës për viça dhe për derra, në projektin e tyre duhet ta përfshijnë edhe depon e plehut me kapacitet të mjaftueshëm për së paku 3 muaj (shiko listën e standardeve minimale kombëtare).
- Në momentin e aplikimit, aplikuesit për majmëri të viçave duhet të dëshmojnë se kanë së paku 0,20 hektar të tokës bujqësore për kokë viçi, në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku 3vjet. Në rast të investimeve në mekanizëm bujqësor për kultivimin e tokës, kohëzgjatja e qirasë duhet të jetë së paku 5 vjet. Kontrata për qiramarrjen duhet të jetë e noterizuar.



## 7. 4 SEKTORI I QUMËSHTIT

- Në momentin e aplikimit, aplikuesit për investime në sektorin e prodhimit të qumështit, përveç pikave grumbulluese, duhet të kenë së paku 10 lopë qumështore ose 100 dele ose 100 dhi në prodhimtari aktive, të regjistruara në Regjistrin e Fermës dhe në Regjistrin për Identifikim dhe Regjistrim të Kafshëve në AUV.
- Pikat grumbulluese duhet të kenë kontrata afatgjate (së paku njëvjeçare) me së paku 10 fermerë të cilët bashkërisht mbarështojnë së paku 80 lopë qumështore.
- Aplikantët që aplikojnë për ndërtimin e stallës, në projektin e tyre duhet të përfshijnë edhe depon e plehut me kapacitet të mjaftueshëm për së paku 3 muaj (shiko listën e standardeve minimale kombëtare).
- Në rast të investimeve në mekanizim bujqësor për kultivimin e tokës, aplikuesit duhet të dëshmojnë se kanë të paktën 0.5 hektar të tokës bujqësore për çdo krerë lope, respektivisht 0.05 hektar të tokës bujqësore për kokë deleje/dhie, në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku 5 vjet. Kontrata për qiramarrjen duhet të jetë e noterizuar.

## 7. 5 SEKTORI I RRUSHIT

- Në momentin e aplikimit, aplikuesit për investime në sektorin e rrushit duhet të dëshmojnë se kanë tokë bujqësore në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku 10 vjet, dhe të regjistruar në Regjistrin e Fermës dhe atë së paku 0.3 hektar. Sipërfaqja minimale e ngastrës duhet të jetë 0.1 hektar.
- Në rast të investimeve në mekanizim dhe pajisje për kultivim dhe vjelje, si dhe depo për trajtim pas vjeljes, aplikuesit duhet të dëshmojnë se kanë së paku 3 hektarë me vreshta, në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku 10 vjet, të regjistruar në Regjistrin e Vreshtave dhe në Regjistrin e Fermës. Kontrata për qiramarrjen duhet të jetë e noterizuar.
- Përfituesit për ngritje të vreshtave të reja, duhet të blejnë vetëm fidanë të importuar nga vendet e BE-së, përveç varieteteve: Vranac, Prokupë, Smederevka, Kallmet, Sheshi i Zi, Sheshi i Bardhë, të cilat mund të jenë të prodhuara edhe në vend ose ndonjë vend tjetër jashtë BE-së. Bashkë me kërkesën për pagesë, përfituesit duhet të dorëzojnë kopjen e certifikatës fito-sanitare mbi gjendjen shëndetësore të materialit fidanor të lëshuar nga prodhuesi, certifikatën mbi prejardhjen e fidanëve dhe në rastin e fidanëve të importuar edhe lejen e importit të ndërmarjes importuese.

## 7. 6 SEKTORI I VEZËVE

- Aplikuesit për investime në sektorin e vezëve, duhet të dëshmojnë posedimin e së paku 5,000 pulave vojse në prodhimtari aktive, të regjistruara në Regjistrin e Fermës.
- Aplikantët që aplikojnë për ndërtimin e fermës së vezëve, në projektin e tyre duhet të përfshijnë edhe depon e plehut me kapacitet të mjaftueshëm për së paku 3 muaj (shiko listën e standardeve minimale kombëtare).

## 8. INVESTIMET E PRANUESHME

Shpenzimet e pranueshme janë të kufizuara në ato që janë përfshirë në Listën e Investimeve të Pranueshme për Masën 101, e paraqitur si Shtojcë nr. 6 e Udhëzuesit për Aplikues.

Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 10,000 €, përveç projekteve për pemë manore dhe projekteve të sektorit të rrushit, ku vlera minimale e projektit është 5,000 €.

**Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 100,000 €, përveç projekteve të sektorit të pemëve manore që është 70,000 €, si dhe sektorit të perimeve dhe serrave (përfshirë patatet), ku vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme është 80,000 €, dhe llogariten si në vijim:**

- Pemë manore  $\geq 0.50$  ha –  $< 1$  ha deri në 35,000 €
- Pemë manore  $\geq 1$  ha -  $\leq 2$  ha deri në 70,000 €
- Serra  $\geq 0.10$  ha –  $< 0.25$  ha deri në 50,000 €
- Serra  $\geq 0.25$  ha –  $\leq 0.50$  ha deri në 80,000 €

Shpenzimet për përgatitjen e planit të biznesit apo projekt-propozimit nuk mund ta tejkalojnë vlerën prej 3% të shpenzimeve të pranueshme. Në rast të investimeve që parashohin ndërtim të stallave apo depove për ruajtjen e pemëve dhe perimeve, shpenzimet për arkitekt dhe inxhinier, leje dhe licenca të ndryshme janë të pranueshme deri në vlerën 7% të shpenzimeve të pranueshme.

## 8. 1 INVESTIMET E PRANUESHME PËR SEKTORË

### 8.1.1 INVESTIMET NË SEKTORIN E PEMËVE

- Investimet në ngritjen e pemishteve të reja me sipërfaqe minimale prej 1 hektar për pemë dru-frutore dhe 0.50 hektar për pemë manore;
- Investimet në vendosjen e sistemeve të ujitjes në fermë, sipas praktikave efikase të ujitjes;
- Investimet në prodhimin e energjisë eficiente në fermë nga të gjitha llojet e burimeve të ripërtërishme;
- Investimet në sistemin e rrjetave për mbrojtje nga breshëri;
- Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për pemishte, për mbrojtje të bimëve, për plehërim, për vjelje dhe trajtim pas vjeljes;
- Investimet për blerje të traktorit për pemët dru-frutore
- Për pemët manore blerja e traktorëve është investim i papranueshëm;
- Investimet në ndërtimin dhe përmirësimin e objekteve për aktivitetet e pas vjeljes, objekteve për vendosjen e makinave, si dhe depove për produkte për mbrojtje të bimëve dhe për plehra artificiale.
- Investimet në dhoma për ftohje ose frigorifer për pemët manore;

### 8.1.2 INVESTIMET NË SEKTORIN E PERIMEVE DHE SERRAVE (PËRFSHIRË PATATET) DHE PËR DEPO

- Investimet në ndërtimin e serrave të përhershme për perime, pemë manore apo fidanë. Sipërfaqja minimale e një serre është 0.1 hektar;
- Investimet në prodhim të energjisë eficiente në fermë nga të gjitha llojet e burimeve të ripërtërishme;
- Blerja dhe instalimi i pajisjeve për arritjen e kushteve të kontrolluara klimatike, përfshirë pajisjet për ngrohje në serra;
- Investimet në vendosjen ose avancimin e sistemeve të ujitjes në serrë sipas praktikave efikase të ujitjes;
- Ndërtimi i objekteve për trajtim pas vjeljes (klasifikim, paketim, etiketim) dhe për ruajtje të prodhimit, si dhe depove për produkte për mbrojtje të bimëve dhe për plehra artificiale.
- Blerja e mekanizmit përkatës për kultivimin e perimeve në fushë të hapur apo në serra (makinë për mbjellje të fidanëve, makinë për shtrirje të folisë.)

### 8.1.3 INVESTIMET NË SEKTORIN E MISHIT

- Ndërtimi/rinovimi/zgjerimi i stallave, objekteve përcjellëse (deponitë e plehut, hangarët e ushqimit voluminoz, depot e silazhit) dhe infrastrukturës në fermë (p.sh. furnizim me ujë në nivel ferme);
- Investimet në pajisje për rritje të zogjve njëditor (pajisje për ngrohje, për ushqim, për furnizim me ujë);
- Investimet në prodhim të energjisë efiçiente në fermë nga të gjitha llojet burimeve tëripërtërishme;
- Investimet në modernizimin e sistemit të ushqimit dhe furnizimit me ujë;
- Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për kultivim të bimëve foragjere dhe drithërave, mbrojtje të bimëve, plehërim dhe korrje;
- Investimet për blerje të traktorit;
- Investimet për pastrimin/largimin e plehut organik (të lëngët dhe të ngurtë) dhe deponimin e tij;
- Investimet për prodhimin e ushqimit të koncentruar, nga kapaciteti total i të cilit, së paku 50% do të përdoret për nevoja të fermës;

### 8.1.4 INVESTIMET NË SEKTORIN E QUMËSHTIT

- Ndërtimi/rinovimi/zgjerimi i stallave, objekteve përcjellëse si dhe objekteve të qendrave grumbulluese të qumështit (deponitë e plehut, hangarët e ushqimit voluminoz, depot e silazhit, mjeltore) dhe infrastrukturës në fermë (furnizim me ujë në nivel ferme);
- Investimet në modernizimin e mjeljes dhe pajisjeve për ftohje, si pajisjet për mjelje, ruajtje të qumështit, përfshirë dhomat e ruajtjes së qumështit, laktofrizat;
- Investimet në prodhim të energjisë efiçiente në fermë nga të gjitha llojet e burimeve tëripërtërishme;
- Investimet në modernizimin e sistemit të ushqimit dhe furnizimit me ujë;
- Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për kultivim të bimëve foragjere dhe drithërave, mbrojtje të bimëve, plehërim dhe korrje;
- Investimet për blerje të traktorit;
- Investimet për pastrimin/largimin e plehut organik (të lëngët dhe të ngurtë) dhe deponimin e tij;
- Investimet për prodhimin e ushqimit të koncentruar, nga kapaciteti total i të cilit, së paku 50% do të përdoret për nevoja të fermës.

### 8.1.5 INVESTIMET NË SEKTORIN E RRUSHIT

- Investimet në ngritjen/modernizimin e plantacioneve të vreshtave (konvertim, zëvendësim) për rrush të tryezës dhe rrush të verës me madhësi minimale 0.3 hektar;
- Investimet në vendosjen e sistemeve të ujitjes, sipas praktikave efikase të ujitjes;
- Investimet në vendosjen e plasmasit për rrush të tryezës;
- Investimet në prodhim të energjisë efiçiente në fermë nga të gjitha llojet e burimeve tëripërtërishme;
- Investimet në sistemin e rrjetave për mbrojtje nga breshëri;
- Investimet në sisteme mbajtëse të hardhive dhe në rrethoja;
- Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për vreshta, makineri për mbrojtje të bimëve, për plehërim, për vjelje dhe trajtim pas vjeljes;
- Investimet për blerje të traktorit;
- Atyre që kanë mbi 3 hektarë sipërfaqe me vreshta u lejohej edhe aplikimi për ndërtimin e objekteve për veprimet pas vjeljes, si depo ftohëse, makineri për klasifikim, pastrim, paketim;

## 8.1.6 INVESTIMET NË SEKTORIN E VEZËVE

- Ndërtimi/rinovimi/zgjerimi i stallave dhe dhomave për ruajtjen e vezëve;
- Investimet në infrastrukturë të brendshme (sistemi i të ushqyerit, ujë-pirëset dhe pajisje për rregullimin e mikroklimës, pajisje për largimin e plehut, klasifikim të vezëve)
- Investimet në kafaze, vetëm sipas standardeve të BE-së;
- Ndërtimi dhe renovimi i depove për ruajtjen e ushqimit, përfshirë pajisjet për përgatitje të ushqimit, trajtim, paketim dhe ruajtje të vezëve;
- Investimet në pajisje efçiente për energji ose prodhim të energjisë në fermë nga të gjithallojet e burimeve të ripërtërishme;
- Investimet për pastrimin/largimin e plehut organik dhe deponimin e tij.
- Investimet për prodhimin e ushqimit të koncentruar, nga kapaciteti total i të cilit, së paku 50% do të përdoret për nevoja të fermës;

## 9. KRITERET E PËRZGJEDHJES PËR NËNSEKTORË

Tabela 1: Kriteret e përzgjedhjes për sektorin e pemëve dru-frutore

Nr.	Lloji i kriterëve	Kriteri / Kategoria	Pikët
1	Kapaciteti prodhues: sipërfaqja që do të ngritet. Në rast të investimit në infrastrukturë të pemishtes, depo, ujitje, mbrojtje kundër breshëri dhe / ose makineri, pikët llogariten varësisht prej sipërfaqes ekzistuese* apo asaj që do të ngritet, cila do qoftë më e madhe.	≥ 5 ha	45
		≥ 3 ha - < 5 ha	40
		≥ 1 ha - < 3 ha	35
2	Kooperativa bujqësore	Aplikuesi është kooperativë bujqësore ose anëtar i kooperativës bujqësore	5
3	Cilësia e materialit fidanor	Investimi në fidanë të prodhuar dhe të certifikuar në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian	5
4	Marrëdhëniet kontraktuese	Kontrata e noterizuar për dorëzim të së paku 50% të prodhimit të fermës (nuk u kërkohet aplikuesve për ngritje të pemishteve të reja; nëse nuk kanë pemishte ekzistuese, ata i marrin 5 pikë nga ky kriter)	5
5	Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik	Investimi në prodhimin e energjisë në fermë nga burimet e ripërtërishme (min. 5% e investimit të pranueshëm). Ky kriter nuk zbatohet kur investimi bëhet në sipërfaqe të mbuluara nga sistemi i ujitjes dhe aplikuesi i merr pikët	5
6	Pronësia mbi tokën ku bëhet investimi	Toka në emër të aplikuesit	5
7	Punësimi	Aplikuesi do të krijojë vende të reja të punës: - për 1 vend pune = 3 pikë - për 2 - 3 vende pune = 7 pikë - për 4 ose më shumë vende pune = 10 pikë	Max. 10
8	Vendi i investimit	Investimi në viset malore	5
9	Përkrahje për herë të parë	Aplikuesi apo ferma nuk ka qenë përfitues i granteve të MBPZHR-së, në tri vitet e fundit	10
10	Arsimimi	Diplomë universitare në bujqësi / teknologji të ushqimit	3
11	Gjinia e fermerit	Aplikuesi femër	2
Gjithsej			100

\* Sipërfaqja ekzistuese të dëshmohet me marrjen e pagesës direkte për këto sipërfaqe në vitin paraprak.

Tabela 2: Kriteret e përzgjedhjes për sektorin e pemëve manore

Nr.	Lloji i kriterëve	Kriteri/Kategoria	Pikët
1	Lloji i investimit: Në rast të investimit edhe nga pika a) edhe nga pika b), pikët llogariten nga investimi me pjesën më të madhe të mjeteve (maksimum 25 pikë)	Ngritja e pemishtës me depo ftohëse ≥ 0.50 ha – ≤ 2 ha	50
		Investimi në infrastrukturë të pemishtës, ujitje, mbrojtje kundër breshërve dhe / ose makineri për sipërfaqe ekzistuese ose të re ≥ 0.50 ha – ≤ 2 ha	45
2	Kooperativa bujqësore	Aplikuesi është kooperativë bujqësore ose anëtar i kooperativës bujqësore	5
3	Cilësia e materialit fidanor	Investimi në fidanë të prodhuar dhe të certifikuar në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian	5
4	Marrëdhëniet kontraktuese	Kontrata e noterizuar për dorëzim të së paku 50% të prodhimit të fermës (nuk u kërkohet aplikuesve për ngritje të pemishteve të reja; nëse nuk kanë pemishte ekzistuese, ata i marrin 5 pikë nga ky kriter)	5
6	Pronësia mbi tokën ku bëhet investimi	Toka në emër të aplikuesit	5
7	Punësimi	Aplikuesi do të krijojë vende të reja të punës: - për 1 vend pune = 6 pikë - për 2 - 3 vende pune = 8 pikë - për 4 ose më shumë vende pune = 10 pikë	Max. 10
8	Vendi i investimit	Investimi në viset malore	5
9	Përkrahje për herë të parë	Aplikuesi apo ferma nuk ka qenë përfitues i granteve të MBPZHR-së, në tri vitet e fundit.	10
10	Arsimimi	Diplomë universitare në bujqësi / teknologji të ushqimit.	3
11	Gjinia e fermerit	Aplikuesi femër	2
Gjithsej			100

Tabela 3: Kriteret e përzgjedhjes për sektorin e perimeve dhe serrave (përfshirë patatet)

Nr	Lloji i kriterëve	Kriteri/Kategoria		Pikët
		Për serra	Për depo	
1	Lloji i investimit	Ndërtimi i serrës me infrastrukturë komplete	Aplikuesi ka së paku 3 ha pemishte tri vjeçare apo më të vjetër ose aplikuesi ka së paku 3 ha tokë që do të mbjellë me perime*	50
			Aplikuesi ka më pak se 3 ha pemishte, prej të cilave së paku 1 ha pemishte tri vjeçare apo më të vjetër ose aplikuesi ka së paku 2 ha tokë që do të mbjellë me perime *	45
2	Kooperativa bujqësore	Aplikuesi është kooperativë bujqësore ose anëtar i kooperativës bujqësore		5
3	Marrëdhëniet kontraktuese	Kontrata e noterizuar për dorëzim të së paku 50% të prodhimit të fermës		10
4	Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik	Investimi në prodhimin e energjisë në fermë nga burimet e ripërtërishme (min. 5% e investimit të pranueshëm)		5

5	Punësimi	Aplikuesi do të krijojë vende të reja të punës: - për 1 vend pune = 6 pikë - për 2 - 3 vende pune = 8 pikë - për 4 ose më shumë vende pune = 10 pikë	Max. 10
6	Pronësia mbi tokën ku bëhet investimi	Toka në emër të aplikuesit	5
7	Përkrahje për herë të parë	Aplikuesi apo ferma nuk ka qenë përfitues i granteve të MBPZHR-së në tri vitet e fundit	10
8	Arsimimi	Diplomë universitare në bujqësi / teknologji të ushqimit	3
9	Gjinia e fermerit	Aplikuesi femër	2
Gjithsej			100

\* Sipërfaqja ekzistuese të dëshmohet me marrjen e pagesës direkte për këto sipërfaqe në vitin paraparak

Tabela 4: Kriteret e përzgjedhjes për sektorin e mishit

Nr	Lloji i kriterëve	Kriteri/Kategoria			Pikët
1	Lloji i investimit: Në rast të investimit edhe nga pika a) edhe nga pika b), pikët llogariten nga investimi me pjesën më të madhe të mjeteve (maksimum 25 pikë)	a) Ndërtimi /rinovimi /zgjerimi i stallës (gropa septike është e detyrueshme për viça dhe derra)			25
		b) Makineri dhe / ose përmirësimi i infrastrukturës së jashtme (depo e plehut, depo e silazhit, depo e sanës)			20
2	Kooperativa bujqësore	Aplikuesi është kooperativë bujqësore ose anëtar i kooperativës bujqësore			5
3	Kapaciteti prodhues (numri i kafshëve) pas realizimit të projektit	Viça	Derra	Brojlerë (zogji)	20
		≥ 20 < 70 krerë	≥ 40 < 100 krerë	≥ 5,000 < 12,000 krerë	
		≥ 70 krerë	≥ 100 krerë	≥ 12,000 krerë	15
4	Përvoja në prodhimin përkatës: aplikuesi ka gjedhe / derra / brojnë prodhim*	Aplikuesi ka së paku 5 krerë	Aplikuesi ka së paku 10 krerë	Aplikuesi ka së paku 1000 brojlerë	5
5	Marrëdhënie kontraktuese	Kontrata e noterizuar për dorëzim të së paku 50% të prodhimit të fermës			5
6	Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik	Investimi në prodhimin e energjisë në fermë nga burimet e ripërtëritshme (min. 5% e investimit të pranueshëm)			5
7	Punësimi <sup>3</sup>	Aplikuesi do të krijojë vende të reja të punës: - për 1 vend pune = 3 pikë - për 2 - 3 vende pune = 7 pikë - për 4 ose më shumë vende pune = 10 pikë			Max. 10
8	Vendi i investimit	Investimi në viset malore			5
9	Përkrahje për herë të parë	Aplikuesi apo ferma nuk ka qenë përfitues i granteve të MBPZHR-së në tri vitet e fundit			10
10	Pronësia mbi tokën ku bëhet investimi	Toka në emër të aplikuesit			5
11	Arsimimi	Diplomë universitare në bujqësi / veterinari / teknologji të ushqimit			3
12	Gjinia e fermerit	Aplikuesi femër			2
Gjithsej					100

\* Të dëshmohet përmes vërtetimit nga Regjistri për Regjistrim dhe Identifikim të Kafshëve, për së paku dy vitet e fundit.

Tabela 5: Kriteret e përzgjedhjes për sektorin e qumështit

Nr	Lloji i kriterëve	Kriteri/Kategoria	Pikët		
1	Lloji i investimit: Në rast të investimit edhe nga pika a) edhe nga pika b), pikët llogariten nga investimi me pjesën më të madhe të mjeteve (maksimum 25 pikë)	a) Ndërtimi / rinovimi / zgjerimi i stallës apo pikës grumbulluese të qumështit	25		
		b) Makineri dhe / ose përmirësimi i infrastrukturës së brendshme dhe të jashtme (depo e plehut, depo e silazhit, depo e sanës)	20		
2	Kooperativa bujqësore	Aplikuesi është kooperativë bujqësore ose anëtar i kooperativës bujqësore	5		
3	Kapaciteti prodhues: numri i kafshëve në prodhimtari aktive para aplikimit ose numri i fermerëve të kontraktuar	Lopë qumështore	Dele/Dhi qumështore	Pikat grumbulluese	
		≥ 10 < 30 krerë	≥ 100 < 300 krerë	≥ 20 fermerë	15
		≥ 30 krerë	≥ 300 krerë	≥ 10 < 20 fermerë	10
4	Marrëdhënie kontraktuese	Kontrata e noterizuar për dorëzim të së paku 50% të prodhimit të fermës	5		
5	Mënyra e mbajtjes pas përfundimit të investimit. Ky kriter vlen vetëm për lopë qumështore. Të tjerët i marrin 10 pikë.	Sistemi i lirë i mbajtjes	10		
		Sistemi i lidhur i mbajtjes	5		
6	Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik	Investimi në prodhimin e energjisë në fermë nga burimet e ripërtërishme (min. 5% e investimit të pranueshëm)	5		
7	Punësimi <sup>3</sup>	Aplikuesi do të krijojë vende të reja të punës: - për 1 vend pune = 3 pikë - për 2 - 3 vende pune = 7 pikë - për 4 ose më shumë vende pune = 10 pikë	Max. 10		
8	Vendi i investimit	Investimi në viset malore	5		
9	Pronësia mbi tokën ku bëhet investimi	Toka në emër të aplikuesit	5		
10	Përkrahje për herë të parë	Aplikuesi apo ferma nuk ka qenë përfitues i granteve të MB-PZHR-së në tri vitet e fundit	10		
11	Arsimimi	Diplomë universitare në bujqësi / veterinar / teknologji të ushqimit	3		
12	Gjinia e fermerit	Aplikuesi femër	2		
Gjithsej			100		

Tabela 6: Kriteret e përzgjedhjes për sektorin e rrushit

Nr	Lloji i kriterëve	Kriteri/Kategoria	Pikët
1.	Kapaciteti prodhues: sipërfaqja që do të ngritet. Në rast të investimit për depo dhe / ose makineri, pikët llogariten varësisht prej sipërfaqes ekzistuese apo asaj që do të ngritet, cilado qoftë më e madhe.	≥ 3 ha	50
		≥ 1 ha - < 3 ha	45
		≥ 0.30 ha - < 1 ha	40
2	Kooperativa bujqësore	Aplikuesi është kooperativë bujqësore ose anëtar i kooperativës bujqësore	5

3	Marrëdhënie kontraktuese	Kontrata e noterizuar për dorëzim të së paku 50% të prodhimit të fermës (nuk u kërkohet aplikuesve për ngritje të vreshtave të reja nëse nuk kanë vreshta ekzistuese, ata i marrin 10 pikë nga ky kriter)	10
4	Pronësia mbi tokën ku bëhet investimi	Toka në emër të aplikuesit	5
5	Punësimi	Aplikuesi do të krijojë vende të reja të punës: - për 1 vend pune = 3 pikë - për 2 - 3 vende pune = 7 pikë - për 4 ose më shumë vende pune = 10 pikë	Max. 10
6	Vendi i investimit	Komuna: Rahovec, Suharekë, Prizren, Gjakovë, Malishevë	5
7	Përkrahje për herë të parë	Aplikuesi apo ferma nuk ka qenë përfitues i granteve të MB-PZHR-së në tri vitet e fundit	10
8	Arsimimi	Diplomë universitare në bujqësi / teknologji të ushqimit	3
9	Gjinia e fermerit	Aplikuesi femër	2
GJITHSEJ			100

Tabela 7: Kriteret e përzgjedhjes për sektorin e vezëve

Nr	Lloji i kriterëve	Kriteri/Kategoria	Pikët
1	Lloji i investimit: Në rast të investimit të kombinuar, pikët llogariten nga investimi me pjesën më të madhe të mjeteve (maksimum 25 pikë)	Ndërtimi / rinovimi / zgjerimi i stallës	25
		Përmirësimi i infrastrukturës së brendshme të fermës; ndërtimi i depove për ushqim; trajtimi i plehut organik; dhomë për ruajtje të vezëve;	20
		Makineri dhe pajisje bujqësore	15
2	Kapaciteti prodhues: numri i pulave vojse në prodhimtari aktive para aplikimit	≥ 5,000 - < 25,000 pula vojse	15
		≥ 25,000	10
3	Mënyra e mbajtjes së pulave	Sistemi i lirë, në natyrë	15
		Sistemi i lirë, në dysheme	10
		Në kafaz, sipas standardeve të BE-së	5
4	Kooperativa bujqësore	Aplikuesi është kooperativë bujqësore ose anëtar i kooperativës bujqësore	5
5	Marrëdhënie kontraktuese	Kontrata e noterizuar për dorëzim të së paku 50% të prodhimit të fermës	5
6	Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimi klimatik	Investimi në prodhimin e energjisë në fermë nga burimet e ripërtërishme (min. 5% e investimit të pranueshëm)	5
7	Punësimi	Aplikuesi do të krijojë vende të reja të punës: për 1 vend pune = 3 pikë për 2 - 3 vende pune = 7 pikë për 4 ose më shumë vende pune = 10 pikë	Max. 10
8	Përkrahje për herë të parë	Aplikuesi apo ferma nuk ka qenë përfitues i granteve të MBPZHR-së në tri vitet e fundit	10
9	Pronësia mbi tokën ku bëhet investimi	Toka në emër të aplikuesit	5
10	Arsimimi	Diplomë universitare në bujqësi / veterinar / teknologji të ushqimit	3
11	Gjinia e fermerit	Aplikuesi femër	2
GJITHSEJ			100

Në rastet kur aplikuesit kanë numër të njëjtë të pikëve, përparësi kanë projektet e dorëzuara më herët.



## 10. SHKALLA E PËRKRAHJES PUBLIKE

- Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 10,000 €, përveç projekteve për pemë manore dhe projekteve të sektorit të rrushit, ku vlera minimale e projektit është 5,000 €.
- Përkrahja publike është 60% e shpenzimeve të pranueshme të investimit përveç për blerjen e traktorit dhe për investimet në sistemin e ngrohjes në serra, me ç'rast përkrahja publike është 20% e cila nuk rritet as për investimet në zona malore dhe as për fermerë të rinj.
- Përkrahje shtesë prej 5% jepet për investime në zonat malore dhe 5% për fermerë të rinj (40 vjeç ose më të rinj).
- Përkrahja maksimale publike për periudhën e zbatimit të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020 për Masën 101 është 400,000 € për përfitues.
- Aplikuesi mund të aplikojë me disa projekte gjatë periudhës së zbatimit të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020, në vite të ndryshme, me kusht që projektet e mëhershme të jenë përfunduar me sukses dhe përkrahja publike të mos tejkalojë shumën e lartpërmendur.

## 11. BUXHETI

Tabela 8: Ndarja e planifikuar buxhetore ndërmjet sektorëve për vitin 2017

Sektorët		Vlera në €	% e buxhetit	
101.1	Për pemë drufrutore	2,500,000	17.24%	
Pemët	Për pemë manore	1,000,000	17.24%	
		1,500,000		
101.2	Serra	3,000,000	20.69%	
Perimet	Depo për ruajtje të perimeve	900,000	6.21%	
101.3	Trashja (majmëria) e viçave	1,400,000	9.66%	
	Mishi	Rritja e brojlerëve (zogjve)	400,000	2.76%
	Trashja e derrave	300,000	2.07%	
101.4	Prodhimi i qumështit nga lopët,	1,500,000	10.34%	
	Qumështi	Prodhimi i qumështit nga delet dhe nga dhitë	500,000	3.45%
	Investimi në pikat grumbulluese të qumështit	400,000	2.76%	
101.5	Sektori i rrushit	800,000	5.52%	
101.6	Sektori i vezëve	300,000	2.07%	
Gjithsej:		14,500,000	100%	

## 12. INDIKATORËT E PROGRAMIT

Tabela 9: Treguesit e monitorimit

Lloji i treguesit	Treguesi	Caku për 2017	
Inputi	Gjithsej:	14,500,000	
	101.1. Sektori i pemëve	5,000,000	
	101.2. Sektori i perimeve dhe serrave (përfshirë patatet)	3,900,000	
	101.3. Sektori i mishit	2,400,000	
	101.4. Sektori i qumështit	2,400,000	
	101.5. Sektori i rrushit	800,000	
	101.6. Sektori i vezëve	300,000	
Outputi	Numri i përgjithshëm i fermave të përkrahura	478	
	Prej të cilave	101.1. Sektori i pemëve	150
		101.2. Sektori i perimeve dhe serrave	125
		101.3. Sektori i mishit	68
		101.4. Sektori i qumështit	68
		101.5. Sektori i rrushit	62
		101.6. Sektori i vezëve	5
	Vlera e investimeve (€)	21,532,500	
	Prej të cilave	101.1. Sektori i pemëve	7,425,000
		101.2. Sektori i perimeve dhe serrave përfshirë patatet	5,791,500
		101.3. Sektori i mishit	3,564,000
		101.4. Sektori i qumështit	3,564,000
		101.5. Sektori i rrushit	1,188,000
		101.6. Sektori i vezëve	445,500
Rezultati	Numri i përgjithshëm i fermave me kapacitet të zgjeruar	373	
	Numri i përgjithshëm i fermave të modernizuara që kanë aplikuar pajisje dhe/ose teknologji të re	419	
	Rritja e madhësisë së fermave të përkrahura	Nr. i hektarëve të shtuar me pemë drufrutore	148
		Numri i hektarëve të shtuar me pemë manore	140
		Numri i m <sup>2</sup> me serra të reja	237,566
		Numri i hektarëve të shtuar me rrush	37
	Numri i kafshëve të shtuara	Lopë qumështore	320
		Pula vojse	26,471
		Brojler (pula/zogj)	66,177
		Gjedhe për majmëri	754
		Derra për majmëri	423
	Numri i pikave të përkrahura grumbulluese të qumështit	12	
	Depo të reja të pemëve dhe perimeve (tonë/vit)	6,500	
	Numri i fermave që kanë investuar në aktivitetet pas vjeljes (paketim, klasifikim, etiketim etj.)	82	
	Numri i fermave që kanë ndërtuar depot e plehut	44	
	Numri i fermave që prodhojnë energji të ripërtërishme	424	
	**Ndikimi	Të hyra shtesë (€/vit)	12,410,000
Vende të reja të punës me orar të plotë		1292	
Rritja e produktivitetit të punës, si rritje (në%) e të hyrave shtesë, bruto për çdo vend pune, në fermat e përkrahura		15%	

\*Caqet janë vendosur në bazë të buxhetit të parashikuar, prandaj çdo ndryshim i buxhetit do të reflektohet proporcionalisht në indikatorë.

\*\*Vlerësimi të bëhet nga vlerësues të pavarur

## **13. PROCEDURA ADMINISTRATIVE**

Kjo masë do të zbatohet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB). Procedurat administrative të detajuara do të paraqiten në Udhëzimin Administrativ, i cili miratohet nga Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

## **14. AFATI I ZBATIMIT**

Afati i zbatimit të projekteve të kësaj mase është 120 ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës me AZHB-në, përveç për sektorin e pemëve, për projektet e të cilit afati i zbatimit është 150 ditë, si dhe për sektorin e rrushit, për projektet e të cilit afati i zbatimit është 300 ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës me AZHB-në. Pas afatit të zbatimit, përfituesi ka edhe 15 ditë shtesë për përgatitjen e dokumentacionit dhe paraqitjen e kërkesës për pagesë. AZHB mund të zgjasë afatin e zbatimit për më së shumti 30 ditë, nëse ka arsye të qëndrueshme për këtë, siç është respektimi i periudhave vegjetative të bimët, sjellja e ndonjë makinerie specifike prej ndonjë vendi tjetër, etj.

## **15. SHTRIRJA GJEOGRAFIKE E MASËS**

Kjo masë aplikohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

# MASA 103:

## INVESTIMET NË ASETET FIZIKE NË PËRPUNIMIN DHE TREGTIMIN E PRODHIMEVE BUJQËSORE PËR VITIN 2017

### 1. BAZA LIGJORE

- Ligji Nr. 03/L-098 - Për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, dt. 1 korrik 2009;
- Ligji Nr. 04/L-090 - Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimit Rural, dt. 16 tetor, 2012;
- Ligji Nr. 03/L-016 - Për Ushqim, dt. 6 mars 2009;
- Ligji Nr. 03/L-029 - Për Inspeksionin Bujqësor, dt. 13 dhjetor 2008;
- Ligji Nr. 02/L-26 - Për Tokën Bujqësore, dt. 23 qershor 2006;
- Ligji Nr. 2005/47 - Për Verërat, dt. 14 tetor 2005;
- Ligji Nr. 04/L-191 - Për Blegtorinë, dt. 28 qershor 2013;
- Ligji Nr. 02/L-10 - Për Përkujdesjen ndaj Kafshëve, dt. 23 Mars, 2005 dhe Rregullore Nr. 2005/24 mbi shpalljen e Ligjit për mirëqenien e kafshëve (UNMIK/REG/2005/24, 9 maj 2005);
- Ligji Nr. 03/L-024 - Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, dt. 19 mars 2009;
- Ligji Nr. 03-L-025 - Për Mbrojtjen e Mjedisit, dt. 19 mars 2009;
- Ligji Nr. 04/L-074 - Për Shërbimet Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, dt. 19 mars 2012;

### 2. ARSYESHMËRIA

Përkrahja për këtë masë është e përqendruar kryesisht në investime në asetet fizike, me qëllim të rritjes së konkurrueshmërisë në sektorin agro-ushqimor, të ndikojë në zëvendësimin e importit të ushqimit me prodhime vendore me cilësi të lartë dhe një produktivitet të përmirësuar.

Kjo masë do të përkrahë investimet në industrinë e përpunimit të ushqimit në katër nënsektorët vijues: përpunim të qumështit dhe prodhimeve të qumështit, përpunim të mishit dhe prodhimeve të mishit, përpunim të frutave dhe perimeve si dhe prodhim të verës. Kjo masë është projektuar për ta plotësuar Masën 101, me synim të rritjes së furnizimit me produkte bujqësore të sigurta dhe pa ndikime negative në mjedis.

Për të konkurruar me sukses në një treg gjithnjë e më të hapur, industria ushqimore ka akoma nevojë për modernizimin e teknologjive dhe përmirësimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë. Industria ushqimore ka për detyrë të krijojë grumbullim të sigurt, transportim dhe deponim të lëndëve të para, zvogëlim të mbeturinave dhe të garantoj sigurinë e ushqimit.

Nën këtë masë, përparësi u jepet investimeve për zbatimin e standardeve të sigurisë së ushqimit që kanë rëndësi të veçantë për furnizimin e tregut vendor me prodhime të sigurta ushqimore dhe për konkurrim të suksesshëm me furnizuesit nga importi. Për të inkurajuar adaptimin e industrisë ush-

qimore me standardet mjedisore, prioritet u është dhënë investimeve që synojnë trajtimin e mbe-turinave, pastrimin e ujit dhe shfrytëzimin efikas të mbetjeve të prodhimit. Investimet e mbështetura në Masën 103 do të kontribuojnë në përmirësimin e situatës së prodhimit bujqësor primar, duke u dhënë përparësi përfituesve që sigurojnë një përqindje të lartë të lëndëve të para me anë të kontratave me fermerët vendorë.

## 2.1 SEKTORI I PËRPUNIMIT TË QUMËSHTIT

Industria e përpunimit të qumështit është një nga sektorët kryesorë të industrisë ushqimore në Kosovë dhe vazhdon të jetë ndër sektorët më të mbështetur. Industria e përpunimit të qumështit ka qenë prioritet kryesor në skemat mbështetëse kombëtare dhe në grantet e BE-së përgjatë viteve të fundit. Megjithatë, mbështetja e dhënë ende nuk i ka plotësuar nevojat për mbulim të investimeve të ndërmarrjeve të përpunimit të qumështit në aspektin e përfrimit me standardet e BE-së në fushat e sigurisë ushqimore, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e investimeve të energjisë së ripërtërishe. Përveç kësaj, sektori i qumështit ka nevojë për investime të konsiderueshme për modernizimin e teknologjive të aplikuara, për ta rritur produktivitetin dhe për t'i ndjekur kërkesat në ndryshim të konsumit. Zinxhirët e mbyllur të ftohjes nga prodhuesi e deri te konsumatori, mjetet e transportit të qumështit me sisteme të ftohjes etj.

Industria e përpunimit të qumështit i ka përqendruar përpjekjet e saj në një gamë të kufizuar të produkteve, kryesisht qumështin dhe produktet e freskëta të qumështit, duke i kushtuar më pak vëmendje djathit, i cili kërkon më shumë njohuri dhe ka një qarkullim të ngadaltë. Disa ndërmarrje të vogla të qumështit kanë futur produkte të reja, të tilla si djath nga qumështi i lopëve, i dhive, i deleve, i buallicave, ajkë e fermentuar, etj.

Janë 39 ndërmarrje<sup>3</sup> që merren me përpunimin dhe paketimin e qumështit të cilat janë të licencuara me kapacitete të ndryshme të instaluar për përpunim dhe të cilat mund të përfitojnë nga kjo masë.

Në këtë grup bëjnë pjesë ndërmarrje të cilat kanë një linjë të plotë të përpunimit të qumështit dhe produkteve të qumështit me një nivel të cilësisë së përafërt me standardet e Bashkimit Evropian (të klasifikuar në kategorinë "A" në aspektin e përputhshmërisë me standardet). Këto ndërmarrje kanë nevojë për investime të mëtejshme teknologjike për ta përmirësuar dhe zgjeruar rrjetin e tyre të furnizimit me lëndë të parë të qumështit, që në mënyrë efektive ta përdorin kapacitetin e prodhimit, për ta forcuar aftësinë e tyre konkurruese dhe për t'i përmirësuar praktikën e menaxhimit të mbe-turinave. Këto ndërmarrje i shfrytëzojnë kapacitetet e tyre prodhuese vetëm pjesërisht. Njësitë më të vogla të përpunimit të qumështit përdorin tashmë një pjesë të mirë të kapacitetit të instaluar të tyre. Disa prej ndërmarrjeve janë duke përdorur mbi 50% të kapacitetit të tyre prodhues. Përmes granteve të BE-së dhe projekteve të mbështetura nga donatorët, disa prej tyre u ndihmuan për të zhvilluar aftësitë dhe strategjitë e marketingut, për të promovuar produkte të reja dhe për ta përmirësuar sigurinë ushqimore. Ato kanë nevojë për mbështetje të mëtejme në linjat e prodhimit, me qëllim të diversifikimit të prodhimeve, rritjes së produktivitetit, zgjerimit dhe për të përmirësuar cilësinë dhe standardet e sigurisë së ushqimit.

Bazuar në shkallën e rrezikshmërisë së cilësisë së ushqimit të këtyre ndërmarrjeve të regjistruara nga ana e AUV-it, për vitin 2016 rezultoi se në kategorinë "A" janë sistemuar 3 ndërmarrje përpunuese, në kategorinë "B" 17, në kategorinë "C" 17 dhe në kategorinë "D", e cila tregon shkallën më të lartë të rrezikut janë sistemuar vetëm 2 ndërmarrje.

3 Lista e objekteve të aprovuara për përpunim dhe paketim të qumështit (AUV, shtator 2016)

## 2. 2 SEKTORI I PËRPUNIMIT TË MISHIT

### 2.2.1 THERTORET

Në Kosovë ekzistojnë 51 thertore<sup>4</sup>, prej tyre 5 thertore shërbejnë për therjen e shpezëve dhe 46 të tjera për therjen e kafshëve të tjera, që janë të regjistruara në AUV dhe janë operacionale. Nga këto ndërmarrje, 4 janë regjistruar në kategorinë "A" (me nivel të ultë të rrezikut), 18 në kategorinë "B", 15 në kategorinë "C" dhe 9 në kategorinë "D" (me nivel të lartë të rrezikut), ndërkaq në kategorizimin e thertoreve të licencuara për shpezë janë regjistruar 3 thertore në kategorinë "B" dhe 2 në kategorinë "C". Përpunuesit e mishit kanë kapacitete të mëdha të pashfrytëzuara si rezultat i prodhimit të pamjaftueshëm të mishit.

Vetëm dy ndërmarrje janë të regjistruara për therjen e ripërtpësve të vegjël që është e pamjaftueshme për t'i mbuluar nevojat, veçanërisht në zonat e thella rurale. Shumica e thertoreve ekzistuese janë pjesë e bizneseve më komplekse (p.sh. përpunimit të mishit të gjedheve, përpunimit të mishit të shpezëve, etj). Thertoret janë ndotës të mëdhenj të mjedisit si nga mbetjet e lëngshme po ashtu edhe nga mbeturinat e ngurta si rezultat i therjeve, prandaj mbështetet mbrojtja e mjedisit, trajtimi i mbetjeve dhe ujrave të shkarkuara. Shumë prej ndërmarrjeve kanë marrë mbështetje për investime edhe nga skemat e granteve të BE-së dhe donatorëve të tjerë, por ka nevojë për mbështetjen të mëtejshme për përmirësimin e standardeve të sigurisë së ushqimit dhe të kontrollit të cilësisë. Diversifikimi i prodhimeve (klasifikimi i mishit dhe produkteve të gatshme sipas kërkesave të konsumatorëve dhe hotelerisë, etj.), mund ta rrisë vlerën e prodhimeve.

Kjo masë do t'i mbështesë thertoret ekzistuese, ndërtimi i objekteve të reja do të mbështetet vetëm nëse bëhet zëvendësimi i objekteve të vjetra me të reja.

### 2.2.2 NDËRMARRJET PËR PËRPUNIM TË MISHIT

Industria e përpunimit të mishit në Kosovë është rritur ndjeshëm në vitet e fundit, por ende karakterizohet nga një numër i kufizuar i produkteve të ofruara.

Aktualisht në Kosovë janë të regjistruara dhe të licencuara 51 ndërmarrje<sup>5</sup> për përpunimin e mishit, të cilat ndahen në tri kategori: 5 ndërmarrje me kapacitete të përpunimit të deklaruar prej 20 ton/ditë ose më shumë, 1 ndërmarrje me kapacitete të përpunimit të deklaruar prej më shumë se 5 dhe më pak se 20 ton/ditë dhe 45 ndërmarrje me kapacitete të përpunimit të deklaruar prej 5 tonë/ditë ose më pak, me nivele të ndryshme të përputhshmërisë për sa i përket kërkesave të sigurisë dhe cilësisë. Nga 55 ndërmarrje të përpunimit të mishit, 6 prej tyre janë klasifikuar në kategorinë "A", 19 në kategorinë "B", 27 në kategorinë "C" dhe 2 në kategorinë "D". Kjo masë do t'i mbështesë ndërmarrjet ekzistuese të përpunimit për të rritur sigurinë e ushqimit, për të mbrojtur mjedisin, për të zbatuar kërkesat e kontrollit të cilësisë, për të zgjeruar llojllojshmërinë e produkteve, futjen e teknologjive të reja të prodhimit dhe të produkteve të reja, si dhe për të investuar në projekte për prodhimin e energjisë së ripërtërishme.

## 2. 3 SEKTORI I PËRPUNIMIT TË PEMËVE DHE PERIMEVE

Pemëtaria konsiderohet si sektor me prioritet të lartë, edhe pse ende karakterizohet me import të lartë për të mbuluar kërkesën vendore. Megjithatë, trendi i fundit tregon që sektori i pemëve po zhvillohet shpejtë. Qëllimi është që të zëvendësohet importi i lartë i pemëve dhe prodhimeve të pemëve me prodhim vendor. Zinxhirit të vlerave të prodhimit dhe përpunimit të pemëve i mungojnë standardet e cilësisë dhe si pasojë e kësaj mungon homogjeniteti i prodhimeve pasi që prodhimet në masë të madhe nuk klasifikohen sipas klasave të cilësisë. Kjo gjithashtu ndikon që shitësit me shumicë të blejnë prodhime të importuara.

<sup>4</sup> Lista e objekteve të aprovuara për therjen e kafshëve (AUV, shtator 2016)

<sup>5</sup> Lista e objekteve të aprovuara për përpunimin e mishit (AUV, shtator 2015)

Viteve të fundit, prodhimi i pemëve ka pasur një rritje si rezultat i shtimit të sipërfaqes dhe rendimenteve. Kosova vazhdon të importojë një sasi të konsiderueshme të pemëve të freskëta, pemëve të thara dhe të përpunuara (kryesisht në formë të konservave dhe lëngjeve). Sektori i përpunimit të pemëve kryesisht është i fokusuar në përpunimin e pemëve drufrutore dhe pemëve manore, pa përjashtuar frutat malore, të cilat rëndom grumbullohen bashkë me bimë të ndryshme aromatike / mjekuese dhe kërpudha.

Kosova ka një traditë të gjatë në përpunimin e perimeve, si një pjesë integrale e zinxhirit të ushqimit të çdo familjeje. Është vlerësuar se një sasi e konsiderueshme e perimeve të përpunuara janë duke u prodhuar në shtëpi dhe për konsum vetanak. Kapaciteti i përpunimit në Kosovë, së paku në aspektin e kapaciteteve përpunuese, në masë të madhe e kalon kapacitetin e prodhimit. Edhe pse sektori është i fragmentuar në përgjithësi, disa nga pjesëmarrësit kryesorë mbulojnë një pjesë të konsiderueshme të tregut.

Në vitet e fundit, përpunuesit e pemëve dhe perimeve kanë filluar të prodhojnë produkte të tilla si reçel frutash, sallata të ndryshme, turshi, lëngje, perime të konservuara, marmelatë, ajvar, etj. Kapaciteti i tharjes është i kufizuar, ndërsa ky sistem është duke u përdorur kryesisht për bimët mjekësore dhe ato aromatike. Qëllimi kryesor i kësaj mase është që të gjitha ndërmarrjet e përpunimit të pemëve dhe perimeve të fokusohen në përmirësimin e cilësisë dhe sigurisë së ushqimit dhe në reduktimin e humbjeve në procesin e përpunimit.

Sistemet e sigurisë ushqimore aplikohen në një numër të kufizuar të ndërmarrjeve. Përfshirja e sistemeve të sigurisë ushqimore kërkon investime në përmirësimin e teknologjisë dhe përmirësimin e kushteve në objektet e prodhimit, si dhe investime në pajisje të kontrollit të kualitetit dhe sisteme të IT-së. Rritja e kapacitetit të deponimit është e nevojshme për përmirësimin e tregut të prodhimeve të hortikulturës dhe patates. Është evidente nevoja për linja të klasifikimit, kategorizimit dhe paketimit, për ta rritur cilësinë e produktit përfundimtar dhe për ta përmirësuar konkurrueshmërinë e sektorit ndaj importeve. Objektet e duhura të pasvjeljes dhe zinxhiri për ftohje janë të një rëndësie të madhe për cilësinë në zinxhirin e vlerës së perimeve. Kërkesat dhe nevojat për objekte të deponimit me sisteme të ftohjes janë në rritje, por ende tejet të kufizuara dhe të përqendruara në disa fusha dhe niveli i arritjes së standardeve të cilësisë ka nevojë për përmirësim. Prandaj, kjo masë mbështet edhe përmirësimin dhe trajtimin e pas vjeljes dhe ruajtjen e lëndës së parë.

## 2.4 SEKTORI I PRODHIMIT TË VERËS

MBPZHR ka licencuar 24 kompani prodhuese të verës dhe të prodhimeve të tjera nga rrushi dhe vera. Tri veraritë më të mëdha përfaqësojnë përafërsisht 90% të kapacitetit të përgjithshëm të prodhimit në këtë sektor, ndërsa veraritë tjera u takojnë prodhuesve të vegjël, disa prej tyre me potencial të mirë për eksport. Po ashtu, ekzistojnë edhe prodhuesit shtëpiak të verës dhe pijeve të forta alkoolike, të cilët në mungesë të mundësive materiale për pajisje, tanqe, infrastrukturë dhe kushte higjienike-sanitare, nuk janë të licencuar nga MBPZHR.

Nësektori i verës ka nevojë për mbështetje, me qëllim të përmirësimin në zbatimin e praktikave më të mira teknologjike. Orientimi aktual i kompanive është tregu i Bashkimit Evropian, i cili është sfidues dhe kërkon ngritjen e cilësisë së verës së prodhuar. Në eksportin e tanishëm mbizotëron tregtimi "refuz" i verës, gjë që nuk ka krijuar një rentabilitet të lartë për kompanitë prodhuese të verës.

Kjo masë ka për qëllim mbështetjen e kompanive prodhuese të verës dhe prodhimeve të tjera nga rrushi dhe vera, të regjistruara në regjistrin e prodhuesve dhe të licencuara nga MBPZHR.

## 3. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

- Rritja e aftësisë konkurruese të bujqësisë kosovare dhe zëvendësimi i importit, përmes rritjes së produktivitetit dhe futjes së teknologjive dhe produkteve të reja;
- Rritja e sigurisë dhe cilësisë së produkteve;
- Përkrahja e ndërmarrjeve në sektorët e përzgjedhur, me qëllim të përafrimit me rregullat, standardet, politikat dhe praktikën e BE-së dhe përmirësimet në mbrojtjen e mjedisit, sigurinë ushqimore dhe cilësinë e produkteve, mirëqenien e kafshëve dhe gjurmueshmërinë e zinxhirit të ushqimit dhe menaxhimin e mbeturinave;
- Përkrahja e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror duke synuar rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, nëpërmjet zhvillimit të fermave;
- Forcimi i lidhjeve me prodhimin primar;
- Adresimi i sfidave të ndryshimit klimatik përmes shfrytëzimit të energjisë së ripërtërishme.

### 3.1 OBJEKTIVAT E VEÇANTA

#### 3.1.1 PËRPUNIMI I QUMËSHTIT

- Zbatimi i standardeve kombëtare dhe atyre të BE-së për prodhimet e qumështit (higjiena, siguria ushqimore, mirëqenia e kafshëve, ruajtja e mjedisit, etj.);
- Modernizimi i linjave të përpunimit të qumështit dhe objekteve të tjera përcjellëse;
- Futja e prodhimeve të reja ose diversifikimi i prodhimeve në industrinë e qumështit;
- Përmirësimi i marketingut të qumështit dhe prodhimeve të tij;
- Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve.

#### 3.1.2 PËRPUNIMI I MISHIT

- Zbatimi i standardeve kombëtare dhe atyre të BE-së për prodhimet e mishit (higjiena, siguria ushqimore, mirëqenia e kafshëve, ruajtja e mjedisit, etj.);
- Futja e linjave të reja të përpunimit të mishit;
- Futja e prodhimeve të reja ose diversifikimi i prodhimeve në industrinë e mishit;
- Modernizimi i thertoreve duke përfshirë thertjet e specializuara (për ripërtypësit e vegjël);
- Përmirësimi i marketingut të mishit dhe produkteve të mishit;
- Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve.

#### 3.1.3 PËRPUNIMI I PEMËVE, PERIMEVE DHE PRODHIMI I VERËS

- Zbatimi i standardeve kombëtare dhe atyre të BE-së (higjiena, siguria ushqimore, cilësia, etj.);
- Përmirësimi i teknologjisë së përpunimit, si dhe modernizimi i objekteve të tjera përcjellëse (depot ruajtëse / ftohëse) duke futur pajisje / teknologji të reja;
- Diversifikimi i prodhimeve;
- Përmirësimi i marketingut;
- Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve



## 4. LIDHJA ME MASAT E TJERA NË PBZHR

Kjo masë ka ndërlidhje me masat e tjera të PBZHR-së, si:

- Masa 101 “Investimet në asetet fizike në ekonominë bujqësore” dhe
- Masa 302 “Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve”

Deri më tani një mbështetje e konsiderueshme është ofruar përmes skemave kombëtare dhe granteve të BE-së për industrinë e përpunimit. Zbatimi i kësaj mase do të bashkërendohet me burime të tjera të mbështetjes, duke pasur parasysh kriteret të forta të ndarjes, të cilat do të krijohen gjatë programimit dhe zbatimit të PBZHR-së.

## 5. PËRFITUESIT PËRFUNDIMTARË

Përfitues mund të jenë ndërmarrjet e përpunimit të qumështit, të mishit, të pemëve dhe të perimeve, si dhe prodhuesit e verës, të regjistruara në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, me përvojë së paku dy vite në nënsektorin përkatës. Përfitues mund të jenë edhe ndërmarrjet e përpunimit të bimëve aromatike / mjekuese dhe të kërpudhave, me kusht që së paku 50% e lëndës së parë që e përpunojnë të jenë fruta malore, pemë dhe / apo perime. Në nënsektorin e verës, aplikuesit duhet të jenë të regjistruar në Regjistrin e Prodhuesve të Verës në Kosovë. Përfituesit përfundimtarë duhet të jenë të regjistruar në Regjistrin e Fermës.

## 6. KRITERET E PËRBASHKËTA TË PRANUESHMËRISË

### 6.1 LLOJET E NDËRMARRJEVE TË PËRKRAHURA

Mund të përkrahen ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të përcaktuara në bazë të Ligjit Nr. 03/L-031 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-5 për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme. Kategoria e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme është e përbërë prej ndërmarrjeve që punësojnë më pak se 250 persona dhe që kanë një qarkullim vjetor që nuk i kalon 50 milionë €, dhe /ose bilanc të gjendjes në total që nuk i kalon 43 milionë € dhe duhet të jenë të regjistruara sipas legjislacionit përkatës si ndërmarrje për përpunimin e ushqimit. Të gjithë aplikuesit duhet të jenë të regjistruar në Agjencionin e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK), në sektorin përkatës, së paku dy vjet para datës së aplikimit.

### 6.2 STANDARDET KOMBËTARE

Te gjithë përfituesit e kësaj mase, në fund të investimit duhet të kenë përfunduar ose të jenë në proces të certifikimit me standardin HACCP dhe / ose standardin ISO 22000. Dëshmia zyrtare e certifikimit të suksesshëm duhet të prezantohet në AZHB jo më vonë se 12 muaj pas përfundimit të projektit.

## 6. 3 QËNDRUESHMËRIA EKONOMIKE E NDËRMARRJES

Të gjithë aplikuesit duhet të paraqesin një plan biznesi, në përputhje me modelin e kërkuar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë. Aplikuesi duhet të demonstrojë në planin e biznesit qëndrueshmërinë ekonomike të ndërmarrjes në fund të realizimit të projektit. Ndërmarrja duhet të demonstrojë se ajo mund t'i kryejë detyrimet dhe borxhet rregullisht, pa vënë në rrezik funksionimin normal të ndërmarrjes. Në rast të ndërtimit / rinovimit / zgjerimit, aplikuesit duhet ta dorëzojnë edhe projektin teknik të planit të ndërtimit / rinovimit / zgjerimit.

Modeli për planin e biznesit dhe udhëzimet për përgatitjen e tij do të jenë pjesë e formularit të aplikimit, të publikuar në ueb faqet e AZHB dhe MBPZHR..

## 6. 4 KRITERET E TJERA TË PRANUESHMËRISË

**Në rastin e projekteve të ndërtimit / renovimit / zgjerimit, aplikuesit me rastin e aplikimit duhet t'i dorëzojnë:**

- Kopjet e skicave të objektit dhe një parallogaritje të shpenzimeve të materialit dhe punëve të parapara;
- Kopjen e planit të parcelës ku do të bëhet investimi;
- Fletën poseduese për parcelën ku do të bëhet investimi;
- Pëlqimin nga organi kompetent (Komuna) për leje të ndërtimit, në rastet e projekteve të ndërtimit / zgjerimit, por jo në rastet e projekteve të rinovimit.

**Ndërsa, para kërkesës për pagesë në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, duhet ta dorëzojë:**

- Lejen për ndërtim nga organi kompetent (Komuna). Leja nuk kërkohet për projektet e rinovimit;
- Vlerësimin e ndikimit në mjedis, nëse është paraparë me ligj;
- Aplikuesit duhet t'i kenë të shlyera detyrimet tatimore, tatimin në të ardhura të korporatave dhe tatimet e tjera të aplikueshme;
- Përfituesit nuk mund t'i jepet një projekt i ri nëse projektet e mëparshme nuk janë përfunduar në përputhje me kontratën e nënshkruar me AZHB;
- Projektet e financuara nga Programi i Zhvillimit Rural 2017 nuk bën të jenë të financuara edhe nga Zyra e BE-së në Kosovë apo ndonjë donator tjetër publik vendor ose ndërkombëtar. Në rast se përfituesi ka përfutuar përkrahje për projektin e njëjtë edhe nga ndonjë donator tjetër, atij nuk i jepet përkrahja ose nëse e ka marrë atë, ai do të detyrohet t'i kthejë mjetet e marra, si dhe ndaj tij do të zbatohen ndëshkimet në përputhje me ligjin;
- Përfituesi i cili ka aplikuar në MBPZHR / AZHB dhe institucione tjera publike apo në zyrën e BE-së në Kosovë dhe projekti i tij përzgjidhet për financim nga ndonjëri prej institucioneve, duhet menjëherë të informojë MBPZHR / AZHB apo institucionet tjera përkatëse;
- Të gjithë përfituesit, të cilët në planin e tyre të biznesit kanë deklaruar se do të krijojnë vende të reja të punës dhe për këtë kanë fituar pikë gjatë vlerësimit, duhet t'i krijojnë ato dhe të dëshmojnë me pagesën e kontributit pensional dhe tatimit në paga duke filluar së paku nga muaji i fundit para kërkesës për pagesën e fundit. Përfituesit janë të obliguar ti mbajnë këto vende pune të plotësuara me punëtorë me orar të plotë për 5 vjet, aq sa zgjat periudha monitoruese;

## 6.5 LISTA KONTROLLUESE PËR PËRZGJEDHJE MJEDISORE

Me rastin e përzgjedhjes së përfituesve, para nënshkrimit të kontratave për financim të projekteve për zhvillim rural, projektet e përzgjedhura do t'i nënshtrohen procedurës së vlerësimit mjedisor, sipas Listës Kontrolluese për Përzgjedhje Mjedisore (shih shtojcën në Udhëzuesin për aplikues – Masa 103-2017). Lista kontrolluese do të plotësohet nga AZHB duke dhënë informata shtesë për rubrikën «Karakteristikat specifike» për t'i sqaruar përgjigjet e dhëna. Nëse një apo më shumë përgjigje në listën kontrolluese është pozitive (PO), atëherë projekti do të ketë ndikim në mjedis, dhe si i tillë kërkon përgatitjen e Planit për Menaxhim Mjedor (PMM).

Masat zbutëse të parashikuara në listën kontrolluese do të jenë pika udhëzuese për përgatitjen e PMM-së. Procesi i aprovimit të projektit kërkon që të gjitha masat zbutëse të propozuara të pranohen dhe të miratohen për zbatim nga ana e aplikuesit. Përgatitja e PMM-së do të jetë obligim i vetë aplikuesit, ndërsa shpenzimet për përgatitjen e tij do të konsiderohen si shpenzime administrative.

## 7. KRITERET E VEÇANTA TË PRANUESHMËRISË

### 7.1 NËNSEKTORËT E PËRPUNIMIT TË QUMËSHTIT DHE TË MISHIT

Të drejtë aplikimi kanë ndërmarrjet të cilat kanë zhvilluar aktivitetin e tyre në sektorin përkatës për së paku 2 vjet para datës së aplikimit dhe janë të regjistruara në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës dhe në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, sipas kategorizimit të ndërmarrjeve për përpunim të ushqimit.

- Kategoria "A" = shkallë e ultë e rrezikut
- Kategoria "B" = shkallë e mesme e rrezikut
- Kategoria "C" = shkallë e lartë e rrezikut
- Kategoria "D" = shkallë shumë e lartë e rrezikut

Aplikuesit e kategorisë "A" dhe "B" nuk janë të pranueshëm në rast të ndërtimit të objektit të ri. Janë të pranueshëm në rast të rinovimit dhe zgjerimit të objektit ekzistues.

Aplikuesit e kategorisë "C" janë të pranueshëm për ndërtim të ri me kusht të mbylljes së objektit ekzistues ose rinovimit, zgjerimit të objektit ekzistues.

Aplikuesit e Kategorisë "D" janë të pranueshëm vetëm në rast të ndërtimit të objektit të ri dhe mbylljes së objektit ekzistues. Këta aplikuesë mund të aplikojnë edhe në pajisje dhe në investime të tjera.

### 7.2 NËNSEKTORËT E PËRPUNIMIT TË PEMËVE DHE TË PERIMEVE

Të drejtë aplikimi kanë ndërmarrjet të cilat kanë zhvilluar aktivitetin e tyre në sektorin përkatës për së paku 2 vjet para datës së aplikimit dhe janë të regjistruara në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës.

Në rast të investimit në qendra të reja grumbulluese dhe paketuese, kapaciteti minimal i ruajtjes duhet të jetë së paku 1000 m<sup>3</sup> të prodhimit. Në rast të zgjerimit të objektit ekzistues ky objekt duhet të ketë kapacitet minimal prej 500 m<sup>3</sup>, ndërsa objekti i zgjeruar duhet të arrijë kapacitetin minimal 1000 m<sup>3</sup>.

## 7.3 NËNSEKTORI I PRODHIMIT TË VERËS

Të drejtë aplikimi kanë ndërmarrjet e regjistruara në Regjistrin e Prodhuesve të Verës dhe prodhuesit e verës që së paku 50% të lëndës së parë (rrushit) e sigurojnë nga prodhuesit e tjerë (jo prodhim vetanak). Ky kriter nuk vlen për prodhuesit e verës që kanë në pronësi mbi 50 ha me vreshta. Aplikuesit duhet të dëshmojnë se e kanë deklaruar prodhimin vjetor të verës dhe të stoqeve të ngelura.

## 8. INVESTIMET E PRANUESHME

- Ndërtimi / rinovimi / zgjerimi i objekteve;
- Blerja e makinerive dhe pajisjeve të reja, duke përfshirë programe kompjuterike të nevojshme për funksionimin e linjave të prodhimit apo funksioneve të tjera primare që ndërlidhen me aktivitetet kryesore të ndërmarrjes;
- Të pranueshme janë investimet në nënsektorët e përpunimit të qumështit, të mishit, të pemëve dhe të perimeve, si dhe prodhimit të verës, përfshirë edhe shpenzimet e marketingut për promovimin e tyre;
- Shpenzimet e pranueshme të marketingut për të gjitha nënmasat e Masës 103 janë: përgatitja dhe shtypja e katalogëve, fletëpalosjeve, broshurave, posterëve, etj., për promovim të produkteve, por jo edhe për shpërndarje të tyre. Po ashtu, shpenzime të pranueshme të marketingut janë edhe prodhimi i audio dhe video-spotëve promovuese, por jo edhe shpërndarja e tyre mediale;
- Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për marketing është e kufizuar në 5% të totalit të shpenzimeve të pranueshme, por jo më shumë se 10,000 €;
- Shpenzimet e tjera të ndërlidhura me projektin, siç janë: shpenzimet për arkitekt, për inxhinier dhe shpenzimet për studime parapake, si dhe nxjerrja e dokumenteve dhe lejeve relevante janë të pranueshme deri në 7% të shpenzimeve të pranueshme por jo më shumë se 15,000 €, kurse shpenzimet për përgatitjen e planit të biznesit janë të pranueshme deri në 3% të shpenzimeve të pranueshme për projekt, por jo më shumë se 5,000 €;
- Shpenzimet administrative, edhe pse ndodhin para nënshkrimit të kontratës, janë të pranueshme vetëm në qoftë se projekti është përzgjedhur dhe është kontraktuar nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

### 8.1 INVESTIMET E PRANUESHME PËR NËNSEKTORË

#### 8.1.1 INVESTIMET E PRANUESHME PËR NËNMASËN E PËRPUNIMIT TË QUMËSHITIT

- Investimet në rinovim / zgjerim dhe modernizim të qumështoreve;
- Investimet në ndërtim të qumështoreve të reja të cilat në kohën e aplikimit janë në kategorinë "C" ose "D";
- Investimet në pajisje për përmirësimin e higjienës, si dhe cilësisë dhe sigurisë së prodhimeve (sidomos për të arritur standardet HACCP dhe / ose ISO 22000);
- Investimet në pajisje për përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit, sidomos për menaxhimin e mbetjeve dhe trajtimin e ujërave të shkarkuara;
- Investimet në mjete transportuese të specializuara;
- Investimet në pajisje për prodhime të reja dhe paketime moderne;
- Pajisje të IT-së, harduer dhe softuer për monitorim, kontroll dhe menaxhim;
- Investimet në teknologji për prodhimin e energjisë së ripërtërishme;
- Investimet në pajisje për ftohje;

## **8.1.2 INVESTIMET E PRANUESHME PËR NËNMAJËN E PËRPUNIMIT TË MISHIT**

### *8.1.2.1 Thertoret*

- Investimet në rinovim / zgjerim dhe modernizim të thertoreve, përfshirë depot ftohëse;
- Investimet në ndërtim të thertoreve të reja të cilat në kohën e aplikimit janë në kategorinë “C” ose “D”;
- Investimet në pajisje për përmirësimin e higjienës, si dhe cilësisë dhe sigurisë së prodhimeve (sidomos për të arritur standardet HACCP dhe / ose ISO 22000);
- Investimet në pajisje për përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit, sidomos për menaxhimin e mbetjeve dhe trajtimin e ujërave të shkarkuara;
- Pajisje për rjepje dhe përgatitje (rethje) të lëkurave;
- Pajisje për thertore, duke përfshirë pajisje për ftohje;
- Kamionë specialë për bartjen e kafshëve të gjalla që i plotësojnë kërkesat për mirëqenien e kafshëve;
- Stalla për vendosjen e kafshëve para therjes;
- Kamionë frigoriferë për bartjen e mishit;
- Makina, pajisje dhe depo për trajtim të mbetjeve dhe nënprodukteve;
- Pajisje të IT-së, harduer dhe softuer për monitorim, kontroll dhe menaxhim;
- Investimet në teknologji për prodhimin e energjisë së ripërtërishme;

### *8.1.2.2 Njësitë për përpunimin e mishit*

- Investimet në rinovim / zgjerim dhe modernizim të objekteve ekzistuese, përfshirë depot ftohëse bashkë me pajisje;
- Investimet në ndërtim të objekteve të reja për përpunim për ndërmarrjet të cilat në kohën e aplikimit janë në kategorinë “C” ose “D”;
- Investimet në pajisje për përpunim të mishit;
- Investimet në pajisje për përmirësimin e higjienës, si dhe cilësisë dhe sigurisë së prodhimeve (sidomos për të arritur standardet HACCP dhe / ose ISO 22000);
- Investimet në pajisje për përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit, sidomos për menaxhimin e mbetjeve dhe trajtimin e ujërave të shkarkuara;
- Investimet për pajisje për kontroll të cilësisë, përfshirë laboratorët përkatës;
- Investimet për pajisje për ftohje dhe ngrirje për ruajtjen e prodhimeve të gatshme;
- Automjete të specializuara për bartjen e lëndës së parë dhe prodhimeve të gatshme;
- Investimet në teknologji për prodhimin e energjisë së ripërtërishme;

## **8.1.3 INVESTIMET E PRANUESHME PËR NËNMAJËN E PËRPUNIMIT TË PEMËVE DHE TË PERIMEVE**

- Investimet në ndërtim, zgjerim, rinovim dhe modernizim të objekteve për përpunim;
- Investimet në linja për konservim / pasterizim të pemëve dhe perimeve;
- Investimet në pajisje për përmirësimin e higjienës, si dhe cilësisë dhe sigurisë së prodhimeve (sidomos për të arritur standardet HACCP dhe / ose ISO 22000);

- Investimet në objekte dhe pajisje për trajtim pas vjeljes, për tharje, për klasifikim dhe për deponim;
- Investimet në pajisje për paketim, për etiketim, përfshirë linjat e mbushjes, mbështjellësit dhe pajisje të tjera të specializuara;
- Investimet në pajisje për zinxhirin ftohës, duke përfshirë depo për ftohje dhe ngrirje, tunele të ngrirjes, mjete transportuese me frigorifer dhe pajisje të tjera të nevojshme për të siguruar vazhdimësinë në zinxhirin e ftohjes;
- Investimet në pajisje për përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit, sidomos për menaxhimin e mbetjeve dhe trajtimin e ujërave të shkarkuara;
- Investimet për pajisje për kontrollë të cilësisë, përfshirë laboratorët përkatës;
- Automjete të specializuara për bartjen e lëndës së parë dhe prodhimeve të gatshme, me ftohje dhe pa ftohje;
- Pajisje të IT-së, harduer dhe softuer për monitorim, kontrollë dhe menaxhim;
- Investimet në teknologji për prodhimin e energjisë së ripërtërishme;

### 8.1.4 INVESTIMET E PRANUESHME PËR NËNMASËN E PRODHIMIT TË VERËS

- Ndërtimi / renovimi / zgjerimi i objekteve për prodhimin dhe përpunimin e verës;
- Investimet në pajisje për përpunimin e verës;
- Investimet në pajisje për përmirësimin e higjienës, si dhe cilësisë dhe sigurisë së prodhimeve (sidomos për të arritur standardet HACCP dhe / ose ISO 22000);
- Investimet në pajisje për paketim, për etiketim, përfshirë linjat e mbushjes, ambalazhës dhe pajisje të tjera të specializuara;
- Investimet në teknologji për prodhimin e energjisë së ripërtërishme;
- Investimet për pajisje dhe aparatura për kontrollë të cilësisë së verës, përfshirë laboratorët përkatës;
- Pajisje të TI-së, harduer dhe softuer për monitorim, kontrollë dhe menaxhim të prodhimit të verës;

## 9. KRITERET E PËRZGJEDHJES

Tabela 1: Nënmasa e përpunimit të qumështit

Nr.	Kriteret e përzgjedhjes	Pikët
1.	Ndërmarrjet që aplikojnë për certifikim me HACCP dhe / ose ISO 22000, të cilat specifikojnë investimet e nevojshme për certifikimin me këto standarde	30
	Ndërmarrjet që janë plotësisht të certifikuara me HACCP dhe / ose ISO 22000	25
2.	Investime që mundësojnë diversifikimin e prodhimit me së paku dy produkte të reja	10
3.	Shitjet e aplikuesit gjatë vitit 2016 si më poshtë: ≥ 200,000 € - < 2,000,000 € - 5 pikë	Max. 10
	≥ 2,000,000 € - < 5,000,000 € - 7 pikë	
	≥ 5,000,000 € - 10 pikë	
4	Aplikuesi nuk ka përfituar grante nga MBPZHR në dy vitet e fundit	10
5.	Përvoja e ndërmarrjes në treg në fushën përkatëse	Max. 10
	Për ≥ 2 - < 5 vjet = 5 pikë Për ≥ 5 vjet = 10 pikë	
6.	Së paku 10% nga investimet e pranueshme i destinohen mbrojtjes së mjedisit: investime për menaxhimin e mbeturinave dhe trajtimin e ujërave të shkarkuara	10

7.	Se paku 5% nga investimet e pranueshme i destinohet prodhimit të energjisë së ripërtëritshme	5
8.	Krijimi i vendeve të reja të punës: për çdo punëtor të ri të punësuar nga 1 pikë, por jo më shumë se 10 pikë në total	Max. 10
9.	Aplikuesit kanë pasur afarizëm pozitiv gjatë 2 viteve të fundit (shih dokumentin: Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve tjera)	5
Gjithsej		100

**Tabela 2: Nënmasa e përpunimit të mishit**

Nr.	Kriteret e përzgjedhjes	Pikët
1.	Ndërmarrjet që aplikojnë për certifikim me HACCP dhe / ose ISO 22000, të cilat specifikojnë investimet e nevojshme për certifikimin me këto standarde	30
	Ndërmarrjet që janë plotësisht të certifikuara me HACCP dhe / ose ISO 22000	25
2.	Për thertoret Futja e linjave të specializuara për therjen e ripërtypësve të vegjël (dele, dhi)	10
	Për përpunuesit e mishit Investime që mundësojnë diversifikimin e prodhimit me së paku dy produkte të reja	10
3.	Së paku 30% e lëndës së parë (kafshë ose mish) të përdorur është nga prodhimi vendor. Kjo duhet të dëshmohet përmes kontratave të noterizuara: në rast të thertoreve, me fermerët, ndërsa në rast të përpunuesve të mishit, me thertoret.	10
4.	Aplikuesi nuk ka përfituar grante nga MBPZHR në dy vitet e fundit	10
5.	Së paku 10% nga investimet e pranueshme i destinohen mbrojtjes së mjedisit: investime për menaxhimin e mbeturinave dhe trajtimin e ujërave të shkarkuara.	10
6.	Së paku 5% nga investimet e pranueshme i destinohet prodhimit të energjisë së ripërtëritshme	5
7.	Përvoja e ndërmarrjes në treg: Për ≥ 2 - < 5 vjet = 5 pikë Për ≥ 5 vjet = 10 pikë	Max. 10
8.	Krijimi i vendeve të reja të punës: për çdo punëtor të ri të punësuar nga 1 pikë, por jo më shumë se 10 pikë në total	Max. 10
9.	Aplikuesit kanë pasur afarizëm pozitiv gjatë 2 viteve të fundit (shih dokumentin: Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve tjera)	5
Gjithsej		100

**Tabela 3: Nënmasa e përpunimit të pemëve dhe të perimeve**

Nr.	Kriteret e përzgjedhjes	Pikët
1.	Investimet për qendrat e deponimit ose qendrat për përpunim: ndërtimi i qendrave të reja apo rinovimi / zgjerimi i qendrave ekzistuese, duke përfshirë pajisje të ftohjes dhe të ngrirjes, pajisje për klasifikim / paketim / etiketim	35
	Kujdes: Në rast të qendrave të deponimit, investimet janë të pranueshme vetëm në objekte me kapacitet së paku 1000 m <sup>3</sup> Pikët nga ky kriter do të llogariten me kusht që së paku 25% e investimit të përgjithshëm i është dedikuar investimit për qendrat e deponimit	
2.	Investime që mundësojnë diversifikimin e prodhimit me së paku dy produkte të reja	10
3.	Përvoja e ndërmarrjes në treg: Për ≥ 2 - < 5 vjet = 5 pikë Për ≥ 5 vjet = 10 pikë	Max. 10

4.	Së paku 80% e lëndës së parë që përpunohet është nga prodhimi vendor. Kjo duhet të dëshmohet përmes kontratave me fermerët, duke përfshirë edhe listën e fermerëve si dhe sasinë e pranuar	10
5.	Aplikuesi nuk ka përfituar grante nga MBPZHR-ja në dy vitet e fundit	10
6.	Së paku 5% nga investimet e pranueshme i destinohen mbrojtjes së mjedisit: investime për menaxhimin e mbeturinave dhe trajtimin e ujrave të shkarkuara	5
7.	Se paku 5% nga investimet e pranueshme i destinohet prodhimit të energjisë së ripërtëritshme	5
8.	Krijimi i vendeve të reja të punës: për çdo punëtor të ri të punësuar nga 1 pikë, por jo më shumë se 10 pikë në total	Max. 10
9.	Aplikuesit kanë pasur afarizëm pozitiv gjatë 2 viteve të fundit (shih dokumentin: Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve tjera)	5
Gjithsej		100

Tabela 4: Nënmasa e prodhimit të verës

Nr.	Kriteret e përzgjedhjes	Pikët
1.	Investimet në linja të prodhimit për verën në shishe, përfshirë për verën e shkumëzuar	30
2.	Investimet në objekte dhe / apo pajisje të ruajtjes. Kujdes: Pikët nga ky kriter do të llogariten me kusht që së paku 25% e investimit të përgjithshëm i është dedikuar investimit sipas këtij kriteri	20
3.	Së paku 80% e rrushit që përpunohet është nga prodhimi vendor. Kjo duhet të dëshmohet përmes sasisë së prodhuar nga vet aplikuesi dhe / apo kontratave me fermerët, duke përfshirë edhe listën e fermerëve si dhe sasinë e pranuar	10
4.	Aplikuesi nuk ka përfituar grante nga MBPZHR në dy vitet e fundit	10
5.	Përvoja e ndërmarrjes në treg: Për $\geq 2$ - $< 5$ vjet = 5 pikë Për $\geq 5$ vjet = 10 pikë	Max. 10
6.	Se paku 5% nga investimet e pranueshme i destinohet prodhimit të energjisë së ripërtëritshme	5
7.	Krijimi i vendeve të reja të punës: për çdo punëtor të ri të punësuar nga 3 pikë, por jo më shumë se 10 pikë në total	Max. 10
8.	Aplikuesit kanë pasur afarizëm pozitiv gjatë 2 viteve të fundit (shih dokumentin: Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve tjera)	5
Gjithsej		100

Vërejtje për të gjitha nënmasat: Në rastet kur aplikuesit kanë numër të njëjtë të pikëve, përparësi kanë projektet e dorëzuara më herët.

## 10. SHKALLA E PËRKRAHJES PUBLIKE

- Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 30,000 €;
- Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 400,000 €;
- Përkrahja publike është 50% e shpenzimeve të pranueshme të investimit;
- Pagesa për Masën 103 bëhet në dy këste, pjesa e parë e përkrahjes publike në vlerë prej 50% bëhet në formë të paradhënies pas nënshkrimit të kontratës me përfituesin, me kusht të sigurimit të garancionit bankar, ndërsa pjesa tjetër e mbetur prej 50%, paguhet pas verifikimit të përfundimit të investimit të përgjithshëm.
- Ndihma maksimale publike për periudhën e zbatimit të programit për bujqësi dhe zhvillim rural 2014-2020 për Masën 103 është 800.000 € për përfitues.
- Aplikuesi mund të aplikojë me disa projekte gjatë periudhës së zbatimit të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020, në vite të ndryshme, me kusht që projektet e mëhershme të jenë përfunduar me sukses dhe përkrahja publike të mos tejkalojë shumën e lartpërmendur.



## 11. BUXHETI

Tabela 13: Ndarja e planifikuar buxhetore, sipas nënmasave:

Nënmasa	Vlera ne €	% e buxhetit
103.1 Qumështi	1,000,000 €	20
103.2 Mishi	1,200,000 €	24
103.3 Pemët dhe perimet	2,000,000 €	40
103.4 Vera	800,000 €	16
<b>Totali</b>	<b>5,000,000 €</b>	<b>100%</b>

## 12. INDIKATORET E PROGRAMIT

Tabela 14: Treguesit e monitorimit

Lloji i Treguesve	Treguesit	Qëllimi 2017	
Të hyrat	Vlera e përgjithshme e mbështetjes publike	5,000,000	
	103.1. Përpunimi i qumështit	1,000,000	
	103.2. Përpunimi i mishit	1,200,000	
	103.3. Përpunimi i përgjithshëm i pemëve dhe perimeve (përfshirë verën)	2,800,000	
	Nga e cila	103.3.1. Përpunimi i pemëve dhe perimeve 103.3.2. Prodhimi i verës	2,000,000 800,000
Outputi	Numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të përkrahura	43	
	103.1. Përpunimi i qumështit	8	
	103.2. Përpunimi i mishit	10	
	103.3. Përpunimi i përgjithshëm i pemëve dhe perimeve (përfshirë verën)	25	
	Nga e cila	103.3.1. Përpunimi i pemëve dhe perimeve 103.3.2. Prodhimi i verës	18 7
	Vlera e përgjithshme të investimeve (€)	11,000,000	
	Nga e cila	Në kapitalin fizik Në marketing	10,450,000 550,000
	103.1. Përpunimi i qumështit	2,200,000	
	103.2. Përpunimi i mishit	3,080,000	
	103.3. Përpunimi i përgjithshëm i pemëve dhe perimeve (përfshirë verën)	6,160,000	
Nga e cila	103.3.1. Përpunimi i pemëve dhe i perimeve 103.3.2. Verërat	4,400,000 1,760,000	
Rezultatet	Numri i ndërmarrjeve me standarde të përmirësuara në përputhje me standartet kombëtare dhe të BE-së në sigurinë e ushqimit/mirëqenien e kafshëve/mjedisit	34	
	Numri i ndërmarrjeve të modernizuara duke përfshirë prodhime të reja dhe/ose teknika të reja të prodhimit	39	
	Numri i ndërmarrjeve me marketing të përmirësuar	34	
	Numri i konsoliduar i fermerëve në bazë të marrëdhënieve kontraktuese	34	
	Numri i ndërmarrjeve që përfshijnë dhe përmirësojnë trajtimin e mbeturinave dhe menaxhimin e tyre	11	
	Numri i ndërmarrjeve që prodhojnë energji të ripërtërishtme	2	

Ndikimi	Rritja ekonomike – si shtesë neto e vlerës bruto të shtuar në ndërmarrjet e mbështetura	15%
	Krijimi i vendeve të punës – nga numri i përgjithshëm bruto si shtesë e Kohës së Plot Ekuivalente (KPE) e krijimit të vendeve të punës në ndërmarrjet e mbështetura	100
	Produktiviteti i punës si ndryshim - Bruto Vlera e Shtuar BVSH për KPE të punës në ndërmarrjet e mbështetura	15%

### 13. PROCEDURA ADMINISTRATIVE

Kjo masë do të zbatohet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB). Procedurat administrative të detajuara do të paraqiten në Udhëzimin Administrativ, i cili miratohet nga Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

### 14. AFATI I ZBATIMIT

Afati i zbatimit të projekteve të kësaj mase është 10 muaj nga dita e nënshkrimit të kontratës me AZHB-në. Pas kësaj periudhe, përfituesi ka edhe 15 ditë shtesë për përgatitjen e dokumentacionit dhe paraqitjen e kërkesës për pagesë. AZHB mund të zgjasë afatin e zbatimit për më së shumti 2 muaj, nëse ka arsye të qëndrueshme për këtë, siç është sjellja e ndonjë makinerie specifike prej ndonjë vendi tjetër, etj.

### 15. SHTRIRJA GJEOGRAFIKE E MASËS

Kjo masë aplikohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

# MASA 302: DIVERSIFIKIMI I FERMAVE DHE ZHVILLIMI I BIZNESEVE

## 1. BAZA LIGJORE

- Ligji Nr.03/L-098 - Për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, (Gazeta Zyrtare Nr. Nr.56/27 Korrik 2009);
- Ligji Nr. 04/L-090 - Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimit Rural, (Gazeta Zyrtare Nr.28/16 Tetor 2012)
- Ligji Nr. 03/L-016 - Për Ushqim; (Gazeta Zyrtare Nr.49/25 Mars.2009)
- Ligji Nr. 03/L-029 - Për Inspeksion Bujqësor; (Gazeta Zyrtare Nr.45/12 Janar.2009)
- Ligji Nr. 04/L-085 - Për Bujqësi Organike (Gazeta Zyrtare Nr.28/16 Tetor 2012);
- Ligji Nr. 02/L-111 - Për Bletari; (Gazeta Zyrtare Nr.35/15 Gusht.2008)
- Ligji Nr.02/L-8 - Për Verërat (Gazeta Zyrtare Nr.9/01 Shkurt.2007).
- Ligji Nr.04/L-019 - Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.02/L-8 për Verërat (Gazeta Zyrtare Nr.13/01 Shtator.2011).
- Ligji Nr. 2004/21 - Për Veterinarinë; (Gazeta Zyrtare Nr.18/01 Nëntor 2007).
- Ligji Nr. 04/L-191 - Për Blegtorinë, dt. 14 tetor 2004; (Gazeta Zyrtare Nr.25/08 Korrik 2013).
- Ligji Nr. 2003/3 - Për Pyjet e Kosovës, dt. 20 mars 2003; (Gazeta Zyrtare Nr.34/01 Gusht 2008);
- Ligji Nr.03/L-153 - Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2003/03 për Pyjet e Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr.67/29 Mars 2010).
- Ligji Nr. 03/L-025 - Për Mbrojtjen e Mjedisit, (Gazeta Zyrtare Nr.50/06 Prill 2009);
- Ligji Nr. 04/L-074 - Për Shërbimet Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural ; (Gazeta Zyrtare Nr.04/19 Mars 2012).

## 2. ARSYESHMËRIA

Zonat rurale kanë një rëndësi të madhe për zhvillimin e përgjithshëm të vendit dhe paraqesin një potencial të madh për diversifikimin e aktiviteteve ekonomike, për krijimin e vendeve të punës dhe krijimin e të hyrave shtesë.

Ekonomia e Kosovës ballafaqohet me shkallë të lartë të papunësisë. Shkalla e papunësisë në vitin 2015 ishte rreth 30% e fuqisë punëtore.<sup>6</sup> Papunësia është më e madhe te gratë dhe te të rinjtë, sidomos në zonat rurale. Kushtet e jetës në zonat rurale janë më të vështira, prandaj është evidente shpërngulja e vazhdueshme drejt zonave urbane.

**Problemet kryesore me të cilat ballafaqohen njerëzit në zonat rurale janë:**

- Mungesa e vendeve të punës;
- Migrimi, sidomos i rinisë;

<sup>6</sup> Raporti i Gjëlber 2015

- Varësia e lartë nga punësimi në bujqësi;
- Mungesa e shërbimeve cilësore në zonat rurale.

Masa 302 “Diversifikimi i fermës dhe zhvillimi i bizneseve” synon krijimin e vendeve të reja të punës dhe ruajtjen e atyre ekzistuese. Përkrahja e aktiviteteve të reja ekonomike duhet të shpijë në uljen e varfërisë në zonat rurale dhe përmirësimin e kushteve të jetesës.

Në pajtim me përfundimet e analizës sektoriale për diversifikimin e ekonomisë rurale në Kosovë, diversifikimi i aktiviteteve ekonomike në zonat rurale shihet si një perspektivë afatgjate për zhvillimin e ekonomisë rurale dhe një mënyrë e përshtatshme për krijimin e punësimit të qëndrueshëm në zonat rurale.

Masa 302 “Diversifikimi i fermës dhe zhvillimi i bizneseve” është masë që e plotëson Masën 101 “Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore”, pasi që Masa 302 mbështet edhe aktivitetet jobujqësore dhe një varg aktiviteteve të tjera që i ofrojnë shërbime popullatës në zonat rurale. Të dy masat do të kontribuojnë në rritjen e të hyrave të ekonomive familjare nga aktivitetet bujqësore dhe nga aktivitetet e tjera në zonat rurale. Në kuadër të masës, përparësi i jepet projekteve të realizuara në zonat malore, të propozuara nga femrat ndërmarrëse dhe fermerët e rinj. Prioritet i lartë gjithashtu i jepet projekteve për krijimin e vendeve të punës dhe projekteve të turizmit rural. Prioritet shtesë do t'u jepet projekteve të rekomanduara nga Grupet Lokale të Veprimt (GLV).

#### **Kjo masë përbëhet nga këto nën masa:**

- 302.1. – Prodhimi, përpunimi dhe promovimi i mjaltit
- 302.2. – Grumbullimi, përpunimi dhe promovimi i prodhimeve jo drusore të malit<sup>7</sup>
- 302.3. – Përpunimi dhe promovimi i prodhimeve bujqësore të kultivuara<sup>8</sup>
- 302.4. – Zhvillimi dhe promovimi i aktiviteteve artizanale<sup>9</sup>
- 302.5. – Zhvillimi dhe promovimi i turizmit rural

## **3. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME**

- Krijimi i vendeve të reja të punës dhe ruajtja e tyre nëpërmjet diversifikimit;
- Krijimi i kushteve të përshtatshme për parandalimin e shpërnguljes së popullatës së zonave rurale dhe zonave malore;
- Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale;

### **3.1 OBJEKTIVAT E VEÇANTA**

- Rritja e të ardhurave të popullatës në zona rurale;
- Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla, duke u bazuar në burimet lokale;
- Ruajtja dhe zhvillimi i aktiviteteve artizanale tradicionale;
- Zhvillimi dhe promovimi i turizmit rural;

<sup>7</sup> bimët mjekuese dhe aromatike, frutat pyjorë dhe kërpudhat e grumbulluara;

<sup>8</sup> perimet, frutat, erëzat, bimët mjekuese dhe aromatike, kërpudhat, qumështi, mushti, vera, rakia nga rushi dhe nga fruta të tjerë, prodhimi i uthullës, përpunimi i brumërave;

<sup>9</sup> përpunimi i tekstit, i lëkurës, i leshit; përpunimi i metaleve; përpunimi i drurit; punët e dorës, si përgatitja e kostumeve tradicionale; thurja e veshmbathjeve tradicionale; prodhimi i pëlhurave të thurura dhe të endura; qëndisja / thurja e qilimave dhe sixhadeve; përgatitja e bizhuterive të ndryshme dhe aktiviteteve të tjera që janë punë artizanale;

## 4. LIDHJA ME MASAT E TJERA NË PBZHR

Kjo masë ka ndërlidhje me masat e tjera të PBZHR-së, si:

- Masa 101 “Investimet në asetet fizike në ekonominë bujqësore”;
- Masa 103 “Investimet në asetet fizike për përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore” dhe
- Masa 303 “Përgatitja dhe zbatimi i strategjive për zhvillim lokal – LEADER”

## 5. PËRFITUESIT PËRFUNDIMTAR

Përfituesit përfundimtar në këtë masë janë fermerët, sipas definicionit nga Ligji Nr. 04 / L- 090 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03L- 098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe ndërmarrjet e tjera bujqësore të regjistruara në Regjistrin e Fermës. Personat juridikë mund të jenë përfitues vetëm nëse janë të regjistruar si ndërmarrje Mikro ose të Vogla sipas definicionit nga Ligji Nr. 03/L-031 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-5 për Mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme:

- Mikrondërmarrja duhet të ketë të punësuar deri nëntë (9) punëtorë;
- Ndërmarrja e vogël duhet të ketë të punësuar prej dhjetë (10) deri dyzet nëntë (49) punëtorë;
- GLV – si përfitues (të akredituara nga Ministria)

## 6. KRITERET E PËRBASHKËTA TË PRANUESHMËRISË

- Duhet të jenë të regjistruar në Regjistrin e Fermës;
- Nëse aplikuesi është person fizik, ai duhet të jetë mbi 18 vjeç, por jo më i vjetër se 65 vjeç;
- Aplikuesit duhet ta dorëzojnë aplikacionin me të gjitha dokumentet e kërkuara në listën e dokumenteve të kërkuara dhe të paraqitura në Udhëzuesin për Aplikues;
- Investimi duhet të kryhet në zona rurale apo zona malore (sipas përkufizimit të MBPZHR-së);
- Aplikuesit duhet ta kenë të kryer së paku shkollën e mesme (në rast të personit juridik kjo vlen për pronarin / personin e autorizuar);
- Aplikuesit duhet t'i kenë të shlyera detyrimet tatimore dhe atë, personat fizikë tatimin në pronë, kurse personat juridikë tatimin në të ardhura të korporatave dhe tatimet e tjera të aplikueshme;
- Aplikuesit nuk duhet të kenë obligime financiare ndaj MBPZHR;
- Të gjithë përfituesit e projekteve të zhvillimit rural obligohen t'i mirëmbajnë investimet e tyre sipas projektit të miratuar gjatë pesë vjetëve pas realizimit të projektit, aq sa zgjat periudha monitoruese. Nëse nuk i mirëmban investimet, përfituesi obligohet ta kthejë shumën e financuar të përkrahjes publike;
- Për projektet investuese në të cilat investimet e pranueshme janë më të vogla ose baras me 20,000 €, aplikuesit duhet ta dorëzojnë një projekt-propozim sipas modelit të AZHB-së . Projekt-propozimi për nënmasën e turizmit rural është i veçantë;
- Për projektet investuese në të cilat investimet e pranueshme janë më të mëdha se 20,000 €, aplikuesit duhet ta dorëzojnë një plan të biznesit sipas modelit të AZHB-së. Plani i biznesit për nën masën e turizmit rural është i veçantë;
- Modelet për projekt-propozim për planin e biznesit do të publikohet në uebfaqen e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) dhe MBPZHR dhe do të jenë në dispozicion për të gjithë aplikuesit;

- Të gjithë përfituesit, të cilët në planin e tyre të biznesit kanë deklaruar se do të krijojnë vende të reja të punës dhe për këtë kanë fituar pikë gjatë vlerësimit, duhet t'i krijojnë ato dhe të dëshmojnë me pagesën e kontributit pensional dhe tatimit në paga duke filluar së paku nga muaji i fundit para kërkesës për pagesën e fundit. Përfituesit janë të obliguar ti mbajnë këto vende pune të plotësuara me punëtorë me orar të plotë për 5 vjet, aq sa zgjat periudha monitoruese;
- Projektet e financuara nga Programi i Zhvillimit Rural 2017 nuk bën të jenë të financuara edhe nga Zyra e BE-së në Kosovë apo ndonjë donator tjetër publik vendor ose ndërkombëtar. Në rast se vertetohet se përfituesi ka përfituar përkrahje për projektin e njëjtë edhe nga ndonjë donator tjetër, atij nuk i jepet përkrahja ose nëse e ka marrë atë, ai do të detyrohet t'i kthejë mjetet e marra, si dhe ndaj tij do të zbatohen ndëshkimet në përputhje me ligjin;
- Përfituesi i cili ka aplikuar në MBPZHR / AZHB dhe institucione tjera publike apo në zyrën e BE-së në Kosovë dhe projekti i tij përzgjidhet për financim nga ndonjëri prej institucioneve, duhet menjëherë të informojë MBPZHR / AZHB apo institucionet tjera përkatëse;
- Përfituesit nuk mund t'i jepet një projekt i ri nëse projektet e mëparshme nuk janë përfunduar në përputhje me kontratën e nënshkruar me AZHB-ën.

#### **Në rast të projekteve të ndërtimit / zgjerimit me rastin e aplikimit duhet të dorëzojnë:**

- Kopjen e skicave dhe vlerësimin e shpenzimeve për materiale dhe për punën;
- Kopjen e planit të parcelës ku do bëhet investimi;
- Fletën poseduese ose kontratën e noterizuar të qirasë për së paku 10 vjet për parcelën ose objektin ku do të bëhet ndërtim / zgjerim, kurse për projektet që nuk parashohin ndërtim / zgjerim në pronë të huaj, mjafton kontrata e noterizuar e qiramarrjes për 5 vjet;
- Në rast të ndërtimit dhe zgjerimit në hapësirat e parqeve nacionale nuk kërkohet leja e ndërtimit nga komuna por kërkohet pëlqimi nga MMPH.

#### **Në rast të projekteve të ndërtimit / zgjerimit, para kërkesës për pagesë në AZHB, përfituesit potencial duhet të dorëzojnë:**

- Lejen ndërtimore nga komuna, në rast të ndërtimeve që janë mbi 10 m<sup>2</sup>;
- Vlerësimin e ndikimit në mjedis, nëse parashihet me Ligj;
- Për nën masën 302.5, përfituesit të cilët planifikojnë të investojnë në objekte që janë në Listën e Trashëgimisë Kulturore, para nënshkrimit të kontratës me Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë duhet ta marrin pëlqimin nga Ministria e Kulturës / Departamenti i Trashëgimisë Kulturore.

## **7. KRITERET E VEÇANTA TË PRANUESHMËRISË**

### **7.1 PRODHIMI, PËRPUNIMI DHE PROMOVIMI I MJALTIT**

#### **Aplikuesit duhet:**

- Të kenë së paku 50 shoqëri (koshere) bletësh.

## 7. 2 GRUMBULLIMI, PËRPUNIMI DHE PROMOVIMI I PRODHIMEVE JO DRUSORE TË MALIT

### Aplikuesit duhet të jenë:

- Person juridik;
- Të licencuar nga Departamenti i Pylltarisë i MBPZHR-së për grumbullimin e bimëve mjekuese dhe aromatike, frutave pyjore dhe kërpudhave. Ky kriter nuk vlen për aplikuesit që aplikojnë për tu pajisur vetëm me tharëse të prodhimeve jodrusore të malit.

## 7. 3 PËRPUNIMI DHE PROMOVIMI I PRODHIMEVE BUJQËSORE TË KULTIVUARA

- Në rast të prodhimit të verës dhe rakisë, aplikuesit duhet të posedojnë më pak së tre (3) hektarë vreshta / pemishte;
- Në rast të përpunimit të qumështit, kapaciteti përpunues i aplikuesve nuk duhet të tejkalojë 500 litra në ditë;

## 7. 4 ZHVILLIMI DHE PROMOVIMI I AKTIVITETEVE ARTIZANALE

Nuk ka kritere të veçanta.

## 7. 5 ZHVILLIMI DHE PROMOVIMI I TURIZMIT RURAL

### Aplikuesit duhet:

- Të dëshmojnë se objekti që do të rinovohet / adaptohet / zgjerohet duhet t'i përshtatet stilit përkatës (tradicional) të zonës rurale dhe të mbështetet me fotografi për ekzistimin e atij objekti me pamje tradicionale (në kohën e aplikimit);
- Përfituesit të cilët planifikojnë të investojnë në objekte që janë në Listën e Trashëgimisë Kulturore, para kërkesës për pagesë me Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, duhet ta marrin pëlqimin nga Ministria përkatëse e Kulturës / Departamenti i Trashëgimisë Kulturore;
- Aplikuesi në momentin e aplikimit duhet ta dorëzojë projektin ideor të përgatitur nga arkitekti, të përshtatur pamjes së objektit siç është paraqitur në fotografi;
- Në rast të projekteve me bujtinë, në fund të investimit objekti duhet të ketë jo më pak se 5 shtretër dhe jo më shumë se 25 shtretër;
- Në rast të investimeve në ndërtimin e shtigjeve për këmbësorë dhe biçiklist përreth objekteve të turizmit rural dhe kur këto shtigje kalojnë nëpër pronë private, me rastin e aplikimit duhet të sillen pëlqimi i noterizuar i pronarëve të pronave nëpër të cilat kalon ky shteg;
- Në rast të investimeve në ndërtimin e shtigjeve për këmbësorë dhe biçiklistë përreth objekteve të turizmit rural dhe kur këto shtigje kalojnë nëpër pronë publike, me rastin e aplikimit duhet të sillen pëlqimi zyrtar nga autoriteti publik përgjegjës për pronat nëpër të cilat kalon ky shteg;

## 8. INVESTIMET E PRANUESHME

- Shpenzimet maksimale të pranueshme për promovim nuk mund të kalojnë 10% të vlerës së gjithmbarshme të investimeve të pranueshme. Investimet për promovimin e produkteve të prodhuara dhe të përpunuara janë: materialet promovuese, pagesat për pjesëmarrje në paigniret lokale / kombëtare, ueb faqja, etj.
- Shpenzimet për përgatitjen e planit të biznesit apo projekt - propozimit nuk mund ta tejkalojnë vlerën prej 3% të shpenzimeve të pranueshme;
- Në rast të investimeve që parashohin ndërtim / rinovim / zgjerim / të objekteve, shpenzimet për arkitekt dhe inxhinier janë të pranueshme deri në vlerën 7% të shpenzimeve të pranueshme.

### 8. 1 INVESTIMET E PRANUESHME SIPAS NËNMASAVE

#### 8.1.1 PRODHIMI, PËRPUNIMI DHE PROMOVIMI I MJALTIT

- Blerja e koshereve pa bletë;
- Blerja e makinerisë dhe pajisjeve për prodhimin dhe përpunimin e mjaltit;
- Rimorkio të specializuara për bartjen e koshereve, vetëm për aplikuesit me mbi 80 koshere;
- Investimet në pajisje për nxjerrjen e produkteve të bletës;
- Investimet në pajisje për kultivimin e mëmave;
- Ndërtimi / rinovimi / zgjerimi i dhomës së mjaltit;
- Blerja e pajisjeve laboratorike për analizim të produkteve të bletëve;
- Blerja e linjave teknologjike për mbushje dhe paketim të mjaltit;
- Blerja e pajisjeve për energji të ripërtërishme;

#### 8.1.2 GRUMBULLIMI, PËRPUNIMI DHE PROMOVIMI I PRODHIMEVE JODRUSORE TË MALIT

- Ndërtimi / renovimi / zgjerimi i objekteve për ruajtjen, përpunimin dhe paketimin e bimëve mjekuese, frutave pyjore dhe kërpudhave të grumbulluara;
- Blerja e pajisjeve për larje, pastrim, ruajtje, klasifikim dhe përpunim;
- Blerja e pajisjeve për tharje, për ftohje, për ngrirje të thellë, etj.;
- Blerja e rafteve për tharje;
- Blerja e pajisjeve për energji të ripërtërishme;
- Blerja e pajisjeve për matje, paketim dhe etiketim;



### **8.1.3 PËRPUNIMI DHE PROMOVIMI I PRODHIMEVE BUJQËSORE TË KULTIVUARA**

- Ndërtimi / renovimi / zgjerimi i objekteve për prodhim, ruajtje dhe përpunim të prodhimeve;
- Ndërtimi / renovimi / zgjerimi i objekteve me pamje tradicionale për përdorim si pika shitëse për prodhimet lokale (të përshkruhet në projekt-propozim);
- Investimet në makina dhe pajisje për përpunimin e qumështit (përfshirë njësitë mobile për prodhimin e djathërave tradicionale), përpunimin e pemëve dhe perimeve, për pastrim, klasifikim, tharje, grumbullim, pasterizim, ruajtje, frigorifer me ftohje, me ngrirje, furra për pjekje të brumërave, përzierëse të ndryshme të brumërave, pajisje për prodhimin e rakisë, pajisje për mbushje për raki dhe verëra, etj.;
- Investimet në blerjen e pajisjeve për matje, paketim dhe etiketim;
- Investimet në blerjen e pajisjeve për energji të ripërtërishme;
- Investimet në pajisje specifike, me qëllim të përmirësimit të sigurisë dhe cilësisë së ushqimit;

### **8.1.4 ZHVILLIMI DHE PROMOVIMI I AKTIVITETEVE ARTIZANALE DHE BIZNESORE**

- Ndërtimi / rinovimi / zgjerimi i objekteve për zhvillimin e aktiviteteve artizanale si dhe për ruajtjen e prodhimeve;
- Ndërtimi / rinovimi / zgjerimi i objekteve me pamje tradicionale për përdorim si pika shitëse për prodhimet lokale (të përshkruhet në projekt-propozim);
- Investimet në blerjen e makinave dhe pajisjeve për thurje dhe për endje të pëlhurave;
- Investimet në blerjen e makinave dhe pajisjeve për punimin e qilimave dhe sixhadeve;
- Investimet në blerjen e makinave dhe pajisjeve për përpunimin e lëkurës;
- Investimet në blerjen e makinave dhe pajisjeve për përpunimin e metaleve;
- Investimet në blerjen e makinave dhe pajisjeve për përpunimin e drurit;
- Investimet në blerjen e makinave dhe pajisjeve të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve të tjera artizanale;

### **8.1.5 ZHVILLIMI DHE PROMOVIMI I TURIZMIT RURAL**

- Rinovimi / adaptimi / zgjerimi i objekteve tradicionale për t'i përdorur si bujtina dhe për ofrimin e shërbimeve gastronomike (me jo më pak se 5 dhe jo më shumë se 25 shtretër);
- Rinovimi / adaptimi / zgjerimi i objekteve me pamje tradicionale (p.sh. mulli, kulla, shtëpi tradicionale, etj.) për përdorim si pika shitëse për prodhimet lokale, për ofrimin e shërbimeve gastronomike tradicionale, për ofrimin e informatave turistike për zonën, etj.;
- Investimet në ndërtimin e shtigjeve për këmbësorë dhe biçiklist përreth objekteve të turizmit rural;
- Blerja e orendive që nevojiten për rregullimin e dhomave, banjove, kuzhinës, sallës së ushqimit (shtretër, ulëse, tavolina, karrige, etj.);
- Blerja e pajisjeve për prodhimin e energjisë së ripërtërishme;
- Blerja e pajisjeve që ofrojnë aktivitete për argëtim të fëmijëve (tobogan, luhatëse, tavolinë ping-pongu, etj.);
- Investimet në krijimin e ueb faqes;

## 9. KRITERET E PËRZGJEDHJES PËR NËNMASA

Tabela 15: Prodhimi, përpunimi dhe promovimi i mjaltit

Nr.	Lloji i kritereve	Kriteri / Kategoria	Pikët
1	Madhësia e fermës në momentin e aplikimit*	50 - 100	35
		101 - 300	25
		> 300	20
2.	Regjistrimi i biznesit	Aplikuesi është i regjistruar në Regjistrin e Bizneseve si prodhues / përpunues i mjaltit	5
3	Kapaciteti i prodhimit të mjaltit: Vlera e prodhimit gjatë vitit paraprak:	≥ 12,000 €	15
		≥ 7,000 - < 12,000 €	10
		≥ 1,000 - < 7,000 €	5
4	Punësimi	Krijimi i një vendi të ri të punës POP10	5
5	Adresa / vendbanimi i aplikuesit**	Ndodhet në zonë malore	10
		Ndodhet në zonë rurale	5
6	Përkrahje për herë të parë	Aplikuesi apo ekonomia e tij familjare nuk ka qenë përfitues i granteve të MBPZHR-së në tri vitet e fundit	10
7	Gjinia	Aplikuesi femër	2
8	Mosha	Aplikuesi është 40 vjeç ose me i ri	5
9	Arsimimi	Diplomë universitare në bujqësi / teknologji të ushqimit	5
10	Bujqësia organike	I certifikuar për prodhim organik	8
Gjithsej			100

\*Numri i koshereve të deklaruar do të krahasohet me numrin e koshereve të vitit paraprak, për të cilat aplikuesi ka përfituar pagesat direkte (subvencionet) përkatëse.

\*\*Adresa e aplikuesit nënkupton vendbanimin e ekonomisë familjare, respektivisht të pronarit të biznesit aplikues.

Tabela 16: Grumbullimi, përpunimi dhe promovimi i produkteve jo drusore të malit

Nr.	Lloji i kritereve	Kriteri / Kategoria	Pikët
1	Kapaciteti i grumbullimit / përpunimit të produkteve jodrusore të malit: Vlera e prodhimit gjatë vitit paraprak	≥ 5,000 €	35
		≥ 1,000 - < 5,000 €	30
		0 - < 1,000 €	25
2	Punësimi	Krijimi i një vendi të ri të punës POP	10
3	Vendi i investimit	Investimi në zonë malore	15
		Investimi në zonë rurale	10
4	Përkrahje për herë të parë	Aplikuesi apo ekonomia e tij familjare nuk kanë qenë përfitues të granteve të MBPZHR-së në tri vitet e fundit	10
5	Gjinia	Aplikuesi është femër	5
6	Arsimimi	Diplomë universitare në bujqësi / pylltari	5
7	Mosha	Aplikuesi është 40 vjeç ose me i ri	10
8	Bujqësia organike	I certifikuar për prodhim organik	10
Gjithsej			100

Tabela 17: Përpunimi dhe promovimi i prodhimeve bujqësore të kultivuara

Nr.	Lloji i kritereve	Kriteri / Kategoria	Pikët
1	Prejardhja e lëndës së parë (të përshkruhet në projekt -propozim ose në plan të biznesit)	Më shumë se 50% të lëndës së parë për përpunim, aplikuesi e prodhon në fermën e vet	45
		Më shumë se 50% të lëndës së parë për përpunim, aplikuesi e siguron nga prodhuesit e tjerë lokal	40
2	Përvoja e aplikuesit në aktivitetet e përpunimit (për personat fizik, të përshkruhet në projekt - propozim ose në plan të biznesit; për personat juridik, të dëshmohet me çertifikatën e biznesit)	Ka përvojë së paku një - vjeçare në aktivitetet për të cilat aplikon	20
		Nuk ka përvojë në aktivitetet për të cilat aplikon	15
3	Punësimi	Krijimi i një vendi të ri të punës (POP)	10
4	Vendi i investimit	Investimi në zonë malore	10
		Investimi në zonë rurale	5
6	Gjinia	Aplikuesi femër	5
		Aplikuesi mashkull	3
7	Mosha	Aplikuesi është 40 vjeç ose më i ri	10
Gjithsej			100

Tabela 18: Zhvillimi dhe promovimi i aktiviteteve artizanale

Nr.	Lloji i kritereve	Kriteri / Kategoria	Pikët
1	Gjinia e aplikuesit	Investimi udhëhiqet nga aplikuesi femër	25
		Investimi udhëhiqet nga aplikuesi mashkull	20
2	Përvoja e aplikuesit në aktivitetet artizanale (për personat fizik, të përshkruhet në projekt - propozim ose në plan të biznesit; për personat juridik, të dëshmohet me çertifikatën e biznesit)	Ka përvojë së paku një vjeçare në ndonjërin nga aktivitetet artizanale për të cilat aplikon	20
		Nuk ka përvojë në ndonjërin nga aktivitetet artizanale për të cilat aplikon	15
3	Mosha	Aplikuesi është 40 vjeç ose më i ri	15
		Aplikuesi është mbi 40 vjeç	10
4	Madhësia e familjes (dëshmohet me çertifikatën e bashkësisë familjare)	9 e më shumë anëtarë	15
		6 deri në 8 anëtarë	10
		Deri në 5 anëtarë	5
5	Vendi i investimit	Investimi në zonë malore	15
		Investimi në zonë rurale	10
6	Punësimi	Krijimi i një vendi të ri të punës POP	10
Gjithsej			100

Tabela 19: Zhvillimi dhe promovimi i turizmit rural

Nr.	Lloji i kriterëve	Kriteri / Kategoria	Pikët
1.	Përvoja e aplikuesit në turizëm rural (për personat fizik, të përshkruhet në projekt - propozim ose në plan të biznesit; për personat juridik, të dëshmohet me certifikatën e biznesit)	Ka përvojë së paku një - vjeçare në ofrimin e shërbimeve të turizmit rural	30
		Nuk ka përvojë në ofrimin e shërbimeve të turizmit rural	20
2.	Vendi i investimit	Investimi në zonë malore	10
		Investimi në zonë rurale	5
3.	Lloji i investimeve: Në rast të investimit edhe nga pika a) edhe nga pika b), pikët llogariten nga investimi me pjesën më të madhe të mjeteve (maksimum 20 pikë)	Investimet në bujtina (së paku 5 shtretër të rinj)	20
		Investimet në ofrimin e shërbimeve gastronomike	15
		Investimet në shtigje për ecje dhe / apo biçikleta	10
4.	Mosha	Ndërmarrësi është i moshës 40 vjeç ose me i ri	5
5.	Gjinia	Investimi udhëhiqet nga aplikuesi femër	2
6.	Punësimi	Aplikuesi do të krijojë vende të reja të punës: - për 1 vend pune = 6 pikë - për 2 - 3 vende pune = 8 pikë - për 4 ose më shumë vende pune = 10 pikë	10
7.	Përkrahje për herë të parë	Aplikuesi apo ekonomia e tij familjare nuk ka qenë përfitues i granteve të MBPZHR-së në tri vitet e fundit	10
7.	Trashëgimia kulturore	Objekti / ndërtesa që do të renovohet është në Listën e Trashëgimisë Kulturore	8
8.	Arsimimi	Diplomë të shkollës së mesme në hoteleri / turizëm	3
9.	Përkrahja nga GLV	Projekti është rekomanduar nga GLV me strategji të miratuar	2
Gjithsej			100

Vërejtje për të gjitha nënmasat: Në rastet kur aplikuesit kanë numër të njëjtë të pikëve, përparësi kanë projektet e dorëzuara më herët.

## 10. SHKALLA E PËRKRAHJES PUBLIKE

- Vlera minimale shpenzimeve të pranueshme për projekt, për të gjitha nën masat e kësaj mase është 5,000 €.
- Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt, për të gjitha nën masat është 30,000 €, përveç për nën masën 302.5 “Zhvillimi dhe promovimi i turizmit rural”, e cila është 50,000 €.
- Përkrahja publike është 65 % e shpenzimeve të pranueshme të investimit.
- Përkrahje shtesë prej 5% jepet për investime në zonat malore.
- Ndhima maksimale publike për periudhën e zbatimit të programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020 për Masën 302 është 150,000€ për përfitues.
- Aplikuesi mund të aplikojë me disa projekte gjatë periudhës së zbatimit të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020, në vite të ndryshme, me kusht që projektet e mëhershme të jenë përfunduar me sukses dhe përkrahja publike të mos tejkalojë shumën e lartpërmendur.

## 11. BUXHETI

Tabela 20: Ndarja e planifikuar buxhetore, sipas nën masave:

Nën masa	Vlera në €	% e buxhetit
302.1. – Prodhimi, përpunimi dhe promovimi i mjaltit	500,000	33.33
302.2. – Grumbullimi, përpunimi dhe promovimi i prodhimeve jodrusore të malit	200,000	13.33
302.3. – Përpunimi dhe promovimi i prodhimeve bujqësore të kultivuara	200,000	13.33
302.4. – Zhvillimi dhe promovimi i aktiviteteve artizanale	200,000	13.33
302.5. – Zhvillimi dhe promovimi i turizmit rural	400,000	26.66
<b>Totali</b>	<b>1,500,000</b>	<b>100%</b>

## 12. INDIKATORËT E PROGRAMIT

Tabela 21: Treguesit e monitorimit

Lloji i treguesit	Totali	1,500,000	
Inputi	302.1. Prodhimi i mjaltit	500,000	
	302.2. Përpunimi i produkteve jodrusore të malit	200,000	
	302.3. Përpunimi i prodhimeve bujqësore të kultivuara	200,000	
	302.4. Zhvillimi i aktiviteteve artizanale	200,000	
	302.5. Zhvillimi i turizmit rural	400,000	
Outputi	Numri i përgjithshëm i projekteve të mbështetura	106	
	prej të cilëve	302.1. Prodhimi i mjaltit	43.33
		302.2. Përpunimi i produkteve jodrusore të malit	17.33
		302.3. Përpunimi i prodhimeve bujqësore të kultivuara	17.33
		302.4. Zhvillimi i aktiviteteve artizanale	17.33
		302.5. Zhvillim i turizmit rural	10.67
Vlera e përgjithshme e investimeve	2,450,250		
prej të cilëve	302.1., Prodhimi i mjaltit	742,500	
	302.2. Përpunimi i produkteve jodrusore të malit	297,000	
	302.3. Përpunimi i prodhimeve bujqësore të kultivuara	297,000	
	302.4. Zhvillimi i aktiviteteve artizanale	297,000	
	302.5. Zhvillim i turizmit rural	594,000	
Numri i vendeve të reja të krijuara	147		
Rezultati	Numri i fermave dhe i ndërmarrjeve që krijojnë burime tjera të të ardhurave nga aktivitetet e diversifikimit.	55	
	Numri i fermave apo ndërmarrjeve që e kanë shtrirë aktivitetin e tyre në drejtim të përpunimit	39	
	Numri i fermave apo ndërmarrjeve me aktivitete të përmirësuara të promovimit	48	
	Numri shtesë i turistëve	1,095	
	Të ardhura shtesë (€/vit) - si të ardhura të përgjithshme shtesë të krijuara në fermat ose ndërmarrjet e mbështetura	305,187	
Impakti	Njësitë e punës bujqësore (pop) rialokohen për aktivitete jo bujqësore	45	

## **13. PROCEDURA ADMINISTRATIVE**

Kjo masë do të zbatohet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB). Procedurat administrative të detajuara do të paraqiten në Udhëzimin Administrativ i cili miratohet nga Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

## **14. AFATI I ZBATIMIT**

Afati i zbatimit të projekteve të kësaj mase është 120 ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës me AZHB-në. Pas periudhës prej 120 ditëve, përfituesi ka edhe 15 ditë shtesë për përgatitjen e dokumentacionit dhe paraqitjen e kërkesës për pagesë. AZHB mund të zgjas afatin e zbatimit për më së shumti 30 ditë, nëse ka arsye të qëndrueshme për këtë, siç është sjellja e ndonjë makinerie specifike prej ndonjë vendi tjetër, etj.

## **15. SHTRIRJA GJEOGRAFIKE E MASËS**

Kjo masë aplikohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

# MASA PËR UJITJEN E TOKAVE BUJQËSORE

## 1. BAZA LIGJORE

- Ligji Nr.04/L-9 - Për Ujitjen e Tokave Bujqësore, dt. 01 prill 2007;
- Ligji Nr.04/L-198 - Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-9 për Ujitjen e Tokave Bujqësore, dt.16 gusht 2010;
- Ligji Nr.04/L-26 - Për Tokën Bujqësore, dt. 01 qershor 2007;
- Ligji Nr. 04/L-147 - Për Ujërat e Kosovës, dt. 29 prill 2013;
- Ligji Nr.04/L-214 - Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, dt. 29 tetor 2010;
- Ligji Nr.04/L-110 - Për Ndërtim, dt. 03 korrik 2012;
- Ligji Nr.04/L-042 - Për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, dt. 19 shtator 2011;
- Ligji Nr.04/L-237 - Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-042 Për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës;

## 2. ARSYESHMËRIA

Zhvillimi i bujqësisë së qëndrueshme, si një nga prioritetet kryesore të Qeverisë së Kosovës nuk mund të arrihet pa shfrytëzimin racional të pasurive ujore si dhe pa vendosjen, rehabilitimin dhe zgjerimin e infrastrukturës së ujitjes.

Derisa në stinët e tjera, të reshurat janë të mjaftueshme, ato mungojnë gjatë stinës së verës. Prandaj imponohet nevoja e akumulimit, grumbullimit dhe strukturimit të ujërave, me qëllim të shfrytëzimit të tyre gjatë verës për nevoja të ujitjes së kulturave bimore.

Gjendja teknike e një pjese të madhe të infrastrukturës së ujitjes nuk është e mirë. Pendat, rezervuarët e ujit, stacionet e ujitjes, pompat, kanalet, gypat, etj., kanë nevojë për rehabilitim, për ndërtime të reja, si dhe për mirëmbajtje të rregullt. Zhvillimi i bujqësisë intensive dhe konkurruese, në kushtet ekonomisë së tregut të lirë, është i pamundur pa zhvillimin e sistemit të ujitjes. Kjo bëhet edhe më e rëndësishme nëse merren parasysh ndryshimet klimatike të viteve të fundit dhe parashikimet për të ardhmen.

## 3. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

- Rritja e produktivitetit të prodhimeve bujqësore;
- Rritja e rendimentit dhe cilësisë së prodhimeve bujqësore;
- Rritja e aftësive konkurruese të prodhimeve bujqësore;

### 3. 1 OBJEKTIVAT E VEÇANTA

- Rritja e sipërfaqeve të ujitura të tokave bujqësore
- Modernizimi i sistemit për ujitje dhe kullim, duke zvogëluar humbjet në sasinë e ujit të përdorur;
- Përmirësimi i lidhjeve të brendshme në rrjetet ekzistuese të ujitjes;

## 4. LIDHJA ME MASAT E TJERA NË PBZHR

- Kjo masë ka ndërlidhje me masat e tjera të PBZHR-së, si:
- Masa 101 “Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore”.

## 5. PËRFITUESIT PËRFUNDIMTARE

- Përfituesit përfundimtarë nën këtë masë janë:
- Fermerët, sipas definicionit nga Ligji Nr. 04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/I-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural;
- Shoqatat e përdorueseve të ujit;
- Kooperativat Bujqësore sipas Ligjit për Kooperativat Bujqësore.

## 6. KRITERET E PËRBASHKËTA TË PRANUESHMËRISË

- Pëlqimi nga kompania publike e ujitjes, në rast se aplikuesi në projektin e tij e parasheh shfrytëzimin e sistemit të ujitjes të kompanive publike.
- Dëshmia që fermerë përfitues nga Masa101 “Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore”, janë përfshirë në projekt, nëse ka të tillë;
- Projekte të pranueshme për financim me mjetet publike janë vetëm projektet që pas përfundimit të investimeve janë në funksion të qëllimit për të cilin është bërë investimi (janë në gjendje për të ujitur tokat bujqësore) dhe kjo duhet të dëshmohet me rastin e kontrollës së fundit në terren. Nëse projektet pas përfundimit të investimit nuk janë funksionale, përfituesi obligohet ta kthejë shumën e financuar të përkrahjes publike të marrë si paradhënie. Të gjithë përfituesit e projekteve të zhvillimit rural obligohen t'i mirëmbajnë investimet e tyre sipas projektit të miratuar gjatë pesë vjetëve pas realizimit të projektit, aq sa zgjat periudha monitoruese. Nëse nuk i mirëmban investimet, përfituesi obligohet ta kthejë shumën e financuar të përkrahjes publike;
- Përfituesit nuk mund t'i jepet një projekt i ri nëse projektet e mëparshme nuk janë përfunduar në përputhje me kontratën e nënshkruar me AZHB.
- Në rast të projektit të ndërtimit apo rindërtimit, aplikanti duhet të paraqes edhe:
- Projektin teknik me paramasë dhe parallogari të investimeve

**Në rast të përzgjedhjes së projektit, para nënshkrimit të kontratës, përfituesi duhet të dorëzojë:**

- Lejen për ndërtim nga organi kompetent i Komunës
- Projektin e detajuar, me paramasë dhe parallogari;
- Vlerësimin e ndikimit në mjedis, nëse parashihet me ligj;



## 7. KRITERET E VEÇANTA TË PRANUESHMËRISË

- Projekti teknik i dorëzuar duhet të demonstrojë zvogëlimin e humbjeve të ujit në minimum 30%, në rastet e modernizimit të sistemeve ekzistuese të ujitjes.
- Përfituesi duhet të kontraktojë kompani ndërtimi me përvojë të mëhershme në ndërtimet e sistemeve të ujitjes që kërkohen në projekt dhe e cila do të garantojë për punët e ndërtimit për së paku 3 vjet pas finalizimit të punës. Kompania e kontraktuar duhet të dëshmojë afarizmin pozitiv për tre vitet e fundit dhe respektimin e Udhëzimit Administrativ për masat dhe kriteret e përkrahjes në bujqësi dhe zhvillim rural 2017, si dhe legjislacionit të prokurimit publik në fuqi.
- Përfituesi duhet të dorëzojë deklaratë me shkrim përmes së cilës garanton se do të participojë me 20% të shumës totale të miratuar për realizimin e projektit.
- Sipërfaqja minimale e projektit nën ujitje duhet të jetë 20 ha.
- Aplikuesit duhet të dëshmojnë të drejtat pronësore të tokës së tyre dhe të gjitha tokave të fermerëve të tjerë ku do të bëhet investimi i propozuar. Kjo nuk kërkohet vetëm në rastet kur pronari i tokës dhe aplikuesi janë në marrëdhënie bashkëshortore apo në vijë të drejtë të gjakut pa kufij (p.sh. stërgjyshërit, gjyshërit, prindërit, fëmijët, nipërit, etj.) dhe kjo dëshmohet përmes certifikatës së martesës, certifikatës së lindjes dhe / apo certifikatës së vdekjes. Po ashtu, aplikuesi duhet të plotësojë Deklaratën nën betim, me të cilën dëshmon se toka me të cilën aplikon është në trashëgimi të tij.

## 8. INVESTIMET E PRANUESHME

- Shpenzimet e pranueshme janë të kufizuara në ato që janë listuar në Listën e Investimeve të pranueshme për Masën Ujitja e Tokave Bujqësore, e paraqitur si Shtojcë Nr. 6 e Udhëzuesit për Aplikues.
- Shpenzimet për përgatitjen e planit të biznesit apo projekt-propozimit nuk mund ta tejkalojnë vlerën prej 3% të shpenzimeve të pranueshme. Në rast të investimeve që parashohin skica, dizajn të hollësishëm inxhinierik, vlerësim të ndikimit në mjedis, shpenzimet për arkitekt dhe inxhinier, leje dhe licenca të ndryshme janë të pranueshme deri në vlerën 7% të shpenzimeve të pranueshme.

## 9. KRITERET E PËRZGJEDHJES

Tabela 22: Kriteret e përzgjedhjes për masën e ujitjes së tokave bujqësore

Kriteri	Parametri	Nr. i pikëve
Kostot-efektive për zgjerimin e sipërfaqeve të ujitura dhe rehabilitimin e rrjeteve ekzistuese të ujitjes	<p>Metoda e kalkulimit: Pasi të jenë vlerësuar të gjitha projektet, nga projektet e pranueshme do të krijohet një hierarki e kostove për ha, duke filluar nga më e ulëta deri tek më e larta.</p> <p>Projekti me koston më të ulët do të marrë numrin maksimal të pikëve, ndërsa projekti me koston më të lartë për ha do të marrë 0 (zero) pikë.</p> <p>Pjesa tjetër e projekteve të pranueshme do të marrë pikët (me 2 decimale) sipas këtij kriteri bazë të koston së tyre për ha, ndërsa rezultatet do të shpërndahen në mënyrë të barabartë.</p> <p>Kalkulimi për poentim: <math>30 \cdot (C_p - \max C) / (\min C - \max C)</math></p> <p><math>C_p</math> – kosto për 1 ha shtesë të ujitur ose 1 ha të modernizuar për ujitje e projektit që vlerësohet.</p> <p><math>\min C</math> – vlera e shpenzime për 1 ha shtesë të ujitur ose 1 ha të modernizuar të ujitjes e projektit me vlerën më të vogël për hektar.</p> <p><math>\max C</math> - vlera e shpenzime për 1 ha shtesë të ujitur ose 1 ha të modernizuar të ujitjes e projektit me vlerën më të madhe për hektar.</p>	Max. 30

Sipërfaqja e ujitur (ha)	≥ 20 - < 50 ha	10
	≥ 50 - < 75 ha	15
	≥ 75 - < 100 ha	20
	≥ 100ha	30
Aplikuesi është anëtar i shoqatës së përdoruesve të ujit për ujitje të tokave bujqësore ose kooperativë bujqësore		10
Numri i fermerëve të regjistruar në Regjistrin e Fermës që përfitojnë nga projekti	1 – 10	10
	11 - 20	15
	më shumë se 20	20
Realizimi i projektit përfshinë përfitues të Masës 101“Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore” në tri vitet e fundit	1 - 5	5
		10
	më shumë se 5	10
Totali		100

Vërejtje: Në rastet kur aplikuesit kanë numër të njëjtë të pikëve, përparësi kanë projektet e dorëzuara më herët.

## 10. SHKALLA E PËRKRAHJES PUBLIKE

- Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt brenda kësaj mase është 20,000 €, kurse vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt është 200,000 €;
- Përkrahja publike është 80% e shpenzimeve të pranueshme të investimit.
- Në rast se vlera e shpenzimeve të pranueshme është më e madhe se 100,000 €, pagesa bëhet në dy këste, pjesa e parë e përkrahjes publike në vlerë prej 50% bëhet në formë të paradhënies pas nënshkrimit të kontratës me përfituesin, me kusht të sigurimit të garancionit bankar, ndërsa pjesa tjetër e mbetur prej 50%, paguhet pas verifikimit të përfundimit të investimit të përgjithshëm. Ndihma maksimale publike për periudhën e zbatimit të programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020 për masën Ujitjes së tokave Bujqësore është 600,000 € për përfitues.
- Aplikuesi mund të aplikojë me disa projekte gjatë periudhës së zbatimit të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020, në vite të ndryshme, me kusht që projektet e mëhershme të jenë përfunduar me sukses dhe përkrahja publike të mos tejkalojë shumën e lartpërmendur.

## 11. BUXHETI

Tabela 23: Ndarja e planifikuar buxhetore:

Sektorët	Vlera në euro	% e buxhetit
Ujitje e Tokave Bujqësore	1,000,000	100%
Totali	1,000,000	100%

## 12. INDIKATORËT E PROGRAMIT

Tabela 24: Treguesit e monitorimit

Lloji i treguesit	Treguesi	Caku
Të dhënat	Vlera e përgjithshme e mbështetjes publike	1,000,000
Prodhimi	Vlera e përgjithshme e investimeve	1,200,000
	Numri i përfituesve të mbështetur	9
Rezultati	Sipërfaqet e zgjeruara të ujitura	600
	Sipërfaqet e modernizuara të ujitjes	600
	Rritja totale e prodhimit (në ton) nga sipërfaqet e ujitura si rezultat i drejtpërdrejtë i investimeve të propozuara, për:	
	Drithërat	1,260
	Perimet	3,920
	Frutat	5,880
	Rrushi	1,960
Ndikimi	Gjithsej ekstra prodhimi bujqësor (euro)	5,165,650

## 13. PROCEDURA ADMINISTRATIVE

Kjo masë do të zbatohet nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB). Procedurat administrative të detajuara do të paraqiten në Udhëzimin Administrativ i cili miratohet nga Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

## 14. AFATI I ZBATIMIT

Afati i zbatimit të projekteve të kësaj mase është 180 ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës me AZHB-në. Pas periudhës prej 180 ditëve, përfituesi ka edhe 15 ditë shtesë për përgatitjen e dokumentacionit dhe paraqitjen e kërkesës për pagesë. AZHB mund të zgjasë afatin e zbatimit për më së shumti 30 ditë, nëse ka arsye të qëndrueshme për këtë.

## 15. SHTRIRJA GJEOGRAFIKE E MASËS

Kjo masë aplikohet në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

## 16. BUXHETI I PËRGJITHSHEM I I PROGRAMIT TË ZHVILLIMIT RURAL 2017

Nr i masës	Emri i masës	Buxheti ne euro	Pjesëmarrja ne %
Masa 101	Investimet në asketet fizike të ekonomive bujqësore	14,500,000	63.04
Masa 103	Investimet në asketet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore	5,000,000	21.73
Masa 302	Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve	1,500,000	6.52
Masa 303	Grupet lokale të veprimt (GLV)	300,000	1.3
Masa 501	Asistenca teknike	200,000	0.88
Masa UTB	Ujitja e tokave bujqësore	1,000,000	4.34
Masa KDFN	Kompensimi i dëmeve nga fatkeqësitë natyrore	500,000	2.17
Totali		23,000,000	100



ARDP  
AGRICULTURE AND RURAL  
DEVELOPMENT PROJECT